Viti XIX, Nr.6334
Botim i PANORAMA GROUP
E MERKURE, 30 SHTATOR 2020

# PanoramA

DREJTOR: ROBERT RAKIPLLARI
KRYEREDAKTOR: REDI GJUZI
Zv.kryeredaktorë: ARISTIR LUMEZI, ETLEVA DELIA
Adresa: Rr. "Panorama" (prapa shkollës "Harry Fultz"), Nd. 3, H. 14. Ap. 3, Njësia Bashkiake Nr. 9, Kodi postar 1016, Tiranë
Fax: 00355 42 403 206, Tel 00355 42 403 207 / 08 / 09 Website: www.panorama.com.al
E-mail: info@panorama.com.al ; gazetapanorama@hotmail.com; gazetapanorama@yahoo.com; marketing@panorama.com.al
ÇMIMI 30 LEKE
(1,5 EURO)

PR PRESTIGE Resort




**SHTOHET PRESIONI NGA GJERMANIA PER QEVERINE: KODI TE KONSULTOHET ME ODIHR**


Johan Vadeful


David Wadephul

## PS shtyn votimin, por nuk tërhiqet nga zgjedhjet pa koalicione, CSU/CDU e "kërcënon" me negociatat

Faqe 2-3

# TE PERNDJEKURIT

## Trashëgimtarët, emrat që marrin këstin e tretë

*Gazeta boton listën e dytë me 2288 emrat e të përndjekurve që marrin paratë e dëmshpërblimit. Në tabela, trashëgimtarët e miratuar nga Ministria e Financave që marrin këstin e tretë* FAQE 15-17

**Anëtari i KLGJ**


Elona Toro

## Vendimi për Elona Toron, karriera e Komisionerit Publik varet nga burri i gjyqtares

Faqe 11

**Apeli i Yuri Kim**

## Mbyllen aplikimet, 500 kandidatë për BKH-në

Faqe 10

**Hetimi**



## SPAK nis pyetjet për Teatrin, Meta: Ata që e shembën, nuk do harrohen

Faqe 8





FAQE 4,5,6,7
RAMA E BASHA, DJE GJATE KONFERENCAVE PER SHTYP

**KRYEMINISTRI DHE KREU I OPOZITES U PERBALLEN NE DISTANCE ME ZGJIDHJE TE NDRYSHME PER TE RINDERTUAR EKONOMINE. ÇFARE PREMTOI RAMA DHE BASHA**

# Nis me ekonominë përballja zgjedhore. Rama premton më pak taksa, Basha plan 312 milionë euro për rimëkëmbjen

**Raporti**



## Nga amnistia te kriza e re ekonomike, FMN pret ditë të këqija: Ekonomia do ulet me 7.5%

**OPINION**

## Manipulimi me listat e hapura


ERGYS MËRTIRI

Debati për listat e hapura po përdoret si zhurmues mediatik për të fshehur thelbin e luftës politike në vend, e cila qëndron pa dyshim te koalicionet. Jo më kot, nga të gjitha variantet që maxhoranca ka propozuar apo diskutuar për këtë çështje, e vetmja gjë që nuk ndryshon është pikërisht heqja e koalicioneve. Kjo mbetet e vetmja shpresë e saj për të mbijetuar...

*vijon në faqen 19*

**OPINION**

## Thellimi i miqësisë dhe i bashkëpunimit kino-shqiptar


ZHOU DING

Më 1 tetor 2020, ne do të festojmë 71-vjetorin e themelimit të Republikës Popullore të Kinës. Për shkak të pandemisë COVID-19, këtë vit Ambasada Kineze në Shqipëri nuk do të organizojë pritje për Festën Kombëtare. Sidoqoftë, kjo nuk do të na ndalojë të...

*vijon në faqen 18*

KODI ZGJEDHOR

DRAFTET

Gjiknuri: Pas 30 korrikut s'mund të ketë koalicion me listë të përbërë

# Kodi, PS nuk tërhiqet për koalicionet parazgjedhore

***Si u shty votimi për ndryshimin e Kodit Zgjedhor në Kuvend dhe pse maxhoranca socialiste nuk i pranon koalicionet tradicionale***

ARDIT HOXHA

**Ndërhyrja në Kodin Zgjedhor për t'iu përshtatur ndryshimeve kushtetuese të 30 korrikut, të hënën pasdite pësoi një deformim të ritmit nga sa ishte parashikuar më herët nga Kuvendi.**

Ishte drafti i opozitës së bashkuar për ndryshimet në Kod, më pas deklaratat e ndërkombëtarëve, të cilat bënë që puna e nisur në Komisionin e Ligjeve mëngjesin e së hënës të ndalohej. Ndryshe nga sa deklaroi kryetari i Komisionit të Ligjeve ditën e hënë, dje nuk u shqyrtuan nen për nen ndryshimet e propozuara nga PS në Kodin Zgjedhor. Gjithashtu, edhe shqyrtimi në seancën plenare u shty, nga e enjtja shkoi për në datën 5 tetor. Gjithsesi, kjo ndalesë dhe shtyrje në kohë e procedurave për ndryshimin e Kodit Zgjedhor nuk do të thotë se Partia Socialiste është tërhequr, por, përkundrazi, do t'i shkojë deri në fund nismës për të diskutuar dhe më pas miratuar draftin e paraqitur në Këshillin Politik.

**KOMISIONI I LIGJEVE**

Edhe pse ditën e enjte është vendosur që të mbahet mbledhja e radhës e Këshillit Politik, në Parlament maxhoranca do të vijojë me punën mbi draftin që ka paraqitur PS për ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Në Komisionin e Ligjeve, sot do të diskutohet drafti bashkë me amendimet që kanë propozuar deputetët e opozitës parlamentare. Mësohet se pas diskutimeve dhe propozimeve që pritet të ketë, ndryshimi në Kodin Zgjedhor do të votohet nen për nen. Ndërkohë, sa i përket votimit në tërësi është vendosur që ai të mos bëhet në mbledhjen e sotme të Komisionit të Ligjeve, por në atë të ditës së premte. Kjo zgjedhje është bërë pikërisht një ditë pas mbledhjes së Këshillit Politik dhe dy ditë para se të kalojë për shqyrtim në seancën plenare të datës 5 tetor. Sakaq, në Komisionin e Ligjeve, prej disa ditësh tashmë është ngritur edhe grupi i punës, i përbërë nga Damian Gjiknuri, Klotilda Bushka dhe Korab Lita, të cilët pritet që të sjellin një draft ku do të përfshihen edhe amendimet që kanë bërë deputetët e opozitës parlamentare. Nëse një gjë e tillë nuk do mund të bëhet nga ky grup pune, Komisioni do t'i shqyrtojë veçmas draftin e PS dhe amendimet e opozitës së re, duke vendosur kështu me forcën e kartonit.

**GJIKNURI**

Në një kohë që axhenda parlamentare për ndryshimet në Kodin Zgjedhor pësoi një deformim të vogël, përfaqësuesi i Partisë Socialiste në Këshillin Politik, Damian Gjiknuri, përmes një letre, ka sqaruar pozicionin e maxhorancës dhe u është përgjigjur çështjeve që ka ngritur opozita e bashkuar. Në letër, Gjiknuri ka shprehur edhe një herë tjetër gatishmërinë që të ulet dhe të diskutojë për ndryshime, por po vënë në diskutim koalicionet. Sipas Damian Gjiknurit, koalicionet me listë të përbërë (tradicionale) nuk mund të përdoren në zgjedhjet e ardhshme dhe kjo gjë, sipas tij, pamundësohet për shkak të ndryshimeve kushtetuese që u votuan në 30 korrik. "Koalicionet dhe mënyra e formatimit të listës së kandidatëve nuk kanë qenë objekt i amendamenteve të datës 23 korrik 2020. Lidhur me çështjen: A duhet të ndryshojë formatimi i listës së kandidatëve për koalicionet për shkak të amendamenteve kushtetuese? Sa herë bëhet fjalë për 'koalicionin me listë të përbërë', çështja paraqitet sikur kemi të bëjmë me një formë e posaçme të organizimit të koalicioneve, kur, në fakt, çështja ka të bëjë vetëm me mënyrën e formatimit të listës, mënyrën e votimit dhe mënyrën përllogaritjes së rezultatit, e cila dallon për këto koalicione nga të gjitha subjektet e tjera që marrin pjesë në zgjedhje. Në thelb, "Koalicioni me listë të përbërë" nuk është gjë tjetër, veçse "votim preferencial për partitë pjesëtare të tij" (citim nga prononcimi i zotit Bylykbashi në një nga mbledhjet e Këshillit Politik). Votimi preferencial për partitë pjesëtare të një koalicioni është kryer në Shqipëri në kushtet kur sistemi zgjedhor parashikonte konkurrimin me lista të mbyllura kandidatësh. Amendamentet kushtetuese të datës 30 Korrik 2020 e ndryshuan këtë realitet", argumentoi Damian Gjiknuri.

**PROCEDURA**

Puna për të implementuar ndryshimet kushtetuese në Kodin Zgjedhor nisi që me rifillimin e jetës parlamentare dhe nga Kuvendi u caktua 30 shtatori si afat final për kalimin nëpër procedurën parlamentare të draftit. Në Konferencën e Kryetarëve u paracaktua që propozimi i PS-së për ndryshimet në Kodin Zgjedhor të miratoheshin në seancën e datës 1 tetor. Por kjo ndryshoi tashmë, pasi formalisht nga kryetarët e 3 grupeve parlamentare të opozitës u kërkua më shumë kohë për të shqyrtuar ndryshimet që po i bëhen Kodit. Në aspektin procedural, sot ndryshimi i Ligjit Zgjedhor pritet të kalojë nen për nen me ose pa përfshirjen e amendimeve të opozitës parlamentare, dhe "vula" do të vihet ditën e premte, kur do të jetë edhe votimi në tërësi, pasi më herët në seancën e së hënës është bërë miratimi në parim.





Damian Gjiknuri

**DRAFTET PËR NDRYSHIMIN E KODIT ZGJEDHOR**

*Për të ndërhyrë për herë të dytë brenda 5 muajsh në Kodin Zgjedhor, deri më tani janë paraqitur dy drafte dhe 2 amendime. Drafti i parë u paraqit nga Partia Socialiste në mbledhjen e datës 17 shtator të Këshillit Politik, ku propozohej një formulë e komplikuar për hapjen e listave, ndalimin e koalicioneve parazgjedhore në formën tradicionale siç kanë qenë deri më tani dhe një prag zgjedhor në rang kombëtar 3%. Mbi këtë draft opozita parlamentare ka bërë disa amendime, ku kërkon uljen e pragut zgjedhor në 1% dhe hapjen e listave me jo më pak se 2/3 si dhe ndryshimin e administratës për numërimin e votave. Ndërsa në draftin e opozitës së bashkuar propozohet hapje e listave në masën 100%, lejimin e koalicioneve me listë të përbërë (tradicional) dhe mosprekjen e formulës për shpërndarjen e mandateve.*

**Gati struktura e re për zgjedhjet, Kuvendi e miraton në 5 tetor**

## Prezantohen 25 kandidatë për KQZ-në e re

***Nga Isaraj te Skënderi, kush doli dje para Komisionit Përzgjedhës***

**Komisioni i Posaçëm për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e kandidaturave për organet drejtuese të KQZ-së zhvilloi dje fazën e parë të dëgjesave me kandidatët që patën plotësuar kriteret formale, sipas procedurave të Rregullores së Kuvendit. Kandidatëve iu kërkua paraqitja e një jetëshkrimi të shkurtër personal, profesional dhe motivet profesionale të aplikimit për njërin nga pozicionet: 25 kandidatët që dolën para Komisionit ishin për pozicionet e Komisionerit shtetëror të zgjedhjeve, Nënkomisionerit, Komisionin Rregullator dhe KAS. Mes 25 kandidatëve të dëgjuar, dje ishin edhe disa personalitete të spikatura të jetës publike në vend. Vlen të theksohen ish-deputeti i PS, Arben Isaraj, anëtari aktual i KQZ-së, Arben Skënderi, ish-nënkryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Elvis Çefa, por edhe juristët Helga Vukaj e Hysen Osmanaj. Në këtë mbledhje të komisionit të posaçëm për përzgjedhjen e KQZ-së re, sipas modelit që është përcaktuar në Kodin Zgjedhor që u votua në 23 korrik, nuk munguan edhe batutat. Pikërisht pas prezantimit të kandidates për një nga pozicionet vakante në KQZ, Hegla Vukaj, mes anëtarëve të Komisionit pati shkëmbim batutash. Ishte deputeti socialist, Alket Hyseni, i cili foli me superlativa për Vukajn, duke e cilësuar atë si një profesioniste të zonjën që do t'i bënte nder KQZ-së. Me të njëjtin nivel konsideratash u shprehën edhe Myslim Murrizi i opozitës parlamentare, por edhe Oerd Bylykbashi i opozitës së bashkuar. Por edhe kryetari i komisionit, Damian Gjiknuri, gjithashtu iu bashkua shkëmbimit të batutave, duke e vlerësuar pozitivisht kandidaturën e Hegla Vukajt. Faza e dytë e dëgjesave të kandidatëve do të zhvillohet sot. Në përmbylljen e kësaj procedure, në Komisionin e Posaçëm pritet që deri në seancën e datës 5 tetor të miratohet e gjithë struktura e re e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Me ngritjen e këtyre strukturave të reja për administrimin zgjedhor, pa humbur kohë pritet të fillojë puna për zgjedhjet e 25 prillit, ku një sfidë e rëndësishme do të jetë identifikimi elektronik i votuesve.**



Komisioni i Posaçëm për kandidatët e KQZ


KESHILLI POLITIK PER REFORMEN ZGJEDHORE

KODI ZGJEDHOR

NDERKOMBETARET

Nënkryetari i CDU/CSU dhe eurodeputeti, apel për konsensus

# CDU/CSU presion qeverisë me integrimin për Kodin Zgjedhor

## *Wadephul: "Jepini ODIHR mundësinë që të vlerësojë ndryshimet"*
## *Lega: "Ndryshimet të respektojnë marrëveshjen e 5 qershorit"*

ARDIT HOXHA

**Presioni dhe thirrjet për konsensus në ndryshimet e Kodit Zgjedhor nga faktori ndërkombëtar kanë vijuar edhe gjatë ditës së djeshme.**


Johan Vadeful


David Wadephul

Ishte nënkryetari i Grupit Parlamentar CDU/CSU, Johann David Wadephul, i cili u bëri thirrje palëve politike në Shqipëri që të arrijë një konsensus në Këshillin Politik në përmbylljen e Reformës Zgjedhore. Sipas numrit dy të grupit parlamentar që qeveris Gjermaninë, palët duhet t'i drejtohen ODIHR-it për të marrë një vlerësim për ndërhyrjen që i bëhet Kodit Zgjedhor. "Kthejuni konsensusit në Këshillin Politik. Dhe jepini ODIHR-it mundësinë që të vlerësojë ndryshimet që do të arrihen në Këshillin Politik për listat zgjedhore. Vetëm nëse thotë ODIHR-i se Reforma Zgjedhore është në përputhje të plotë me kriteret e OSBE/ODIHR-it, atëherë edhe ne do ta kemi të lehtë që të themi se është plotësuar edhe kushti i Reformës Zgjedhore". Wadephul u shpreh kështu për "Deutsche Welle" pas takimit që ai pati në Berlin me ministrin në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj. Wadephul theksoi se Gjermania e mbështet Shqipërinë në plotësimin e gjashtë kushteve të vëna nga Bundestagu, por ai shtoi se vendi ka ende shumë punë për të bërë.

**DAVID LEGA**

Edhe eurodeputeti David Lega, pjesë e Grupit të Partive Popullore Europiane, ka bërë apel që çdo ndryshim i mëtejshëm në kuadër të Reformës Zgjedhore duhet të bëhet me konsensus dhe mbi bazën e fjalës që palët kanë dhënë kur kanë firmosur marrëveshjen e 5 qershorit. Ai kujtoi edhe një herë tjetër se një Reformë Zgjedhore konsensuale është pjesë e kushteve për rrugën europiane të Shqipërisë. "Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë një parakusht themelor i integrimit në BE. Reforma Zgjedhore e 5 qershorit u miratua në mënyrë konsensuale dhe u mbështet ndërkombëtarisht dhe duhet të zbatohej siç ishte rënë dakord. Ndryshimet e njëanshme në këtë fazë janë kundër rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it si dhe vendimit të Këshillit të BE-së për hapjen e negociatave të pranimit. PPE nxit autoritetet të përmbahen nga çdo ndryshim i njëanshëm dhe të respektojnë marrëveshjen konsensuale siç janë zotuar", shkroi në postimin e tij në rrjetin social "Twitter", David Lega.

## DEKLARATAT

Të hënën pati një seri qëndrimesh nga ambasadorët e SHBA-së dhe BE-së në vendin tonë, por edhe nga Asambleja e PPE-së, që iu bënin thirrje palëve për të gjetur konsensusin për ndryshimet kushtetuese. Këto thirrje të faktorit ndërkombëtar erdhën fill pasi opozita e bashkuar prezantoi draftin e saj për ndryshimet në Kodin Zgjedhor.

REAGIMI

Ministri i Brendshëm: Lista publikohet për herë të parë më 5 tetor

# Nis lufta për listat e zgjedhësve

## *Lleshaj: S'ka ndryshime të qendrave të votimit për qytetarët*


Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj

Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, ka hedhur poshtë çdo akuzë për ndërhyrje dhe manipulime ne listat e zgjedhësve. Lleshaj e ka cilësuar si një çështje të ngritur në ajër gjithë këtë histori dhe siguri që në datë 5 tetor do të publikohet ekstrakti i parë i zgjedhësve, që do të kenë të drejtën e votës më 25 prill 2021. "Nuk ka asnjë lloj ndryshimi të qendrave të votimit për qytetarët. Asnjë! Dhe nuk do të ketë asnjë ndryshim arbitrar të qendrave të votimit. Në bazë të detyrimeve të Kodit Zgjedhor, ekstrakti i parë i listës së zgjedhësve do të publikohet pas disa ditësh, saktësisht në datën 5 tetor 2020, dhe të gjithë do kenë mundësinë të verifikojnë këtë të vërtetë të thjeshtë", vuri në duke ministri i Brendshëm. Kjo është e vetmja e vërtetë për këtë trillim të turpshëm mediatik. Por, siç e thashë në krye të herës, trilluesit e lajmit e kanë përdorur të gjithë teknologjinë e tyre të mashtrimit duke e paketuar gënjeshtrën me një tjetër të vërtetë. Pak a shumë, sipas logjikës, tani nuk ka diell sepse këta e kanë vjedhur atë. Në fakt është e vërtetë se tani nuk duket dielli, por kjo nuk do të thotë se e ka vjedhur kush atë. Nga verifikimet paraprake të pretendimeve të bëra publike nga disa media nën ndikim, rezulton se qytetarët e paraqitur si votues të djathtë dhe të përdorur për të ilustruar mashtrimin publik kanë thënë të pavërteta. Por për këtë do të ketë më shumë hollësi në ditët në vijim, pasi të thellohen më tej verifikimet përkatëse", tha ministri Lleshaj, duke iu përgjigjur kështu edhe akuzave që u ngritën nga Partia Demokratike për manipulim të listave për të favorizuar qeverinë.

Më tej, ministri i Brendshëm foli edhe për sistemin e adresave, që sipas tij gjatë këtyre viteve të fundit ka pësuar një transformim shumë të madh. "Po zbatohet më në fund projekti për sistemin funksional të adresave në Shqipëri. Kaosi i tranzicionit në vendin tonë, krahas shumë shkatërrimesh të tjera, solli edhe zhbërjen e sistemit të adresave të qytetarëve. Për dekada të tëra, qytetarët e këtij vendi janë endur nëpër Shqipëri dhe nëpër botë pa një adresë të saktë të vendbanimit, a thua se janë nomadë. Kjo gjendje amullie në vendbanim ka sjellë kosto të pallogaritshme në funksionimin e jetës shoqërore, ofrimin e shërbimeve, administrimin e vendit, sigurinë publike, zhvillimin e zgjedhjeve etj. Tashmë të gjithë e dinë se adresat në qytetet e vendit tonë, ndryshe nga vendet normale, për shumë vite jepeshin si përshkrime udhëtimi përmes paragrafëve të tilla si: Te Pallati me Shigjeta, 100 metra në të djathtë të karburantit të verdhë… te Bërryli, prapa Oxhakut, etj… Njerëzit ishin pajtuar me këtë absurditet, aq sa, nëse ndonjë kryebashkiak do të merrte vendimin e guximshëm për ta lyer ndryshe Pallatin me Shigjeta, mijëra qytetarë do të humbnin këtë adresën e tyre", tha Lleshaj.

FUSHATA ZGJEDHORE

QEVERIA

Kryeministri nis fushatën, prezanton shifrat dhe afatet e rindërtimit nga tërmeti

# Rindërtimi, Rama: Proces i rimëkëmbjes me rritje të konsiderueshme ekonomike

*"Shqipëria ka paketën më të madhe të investimeve publike në historinë e saj dhe pa cenuar konsolidimin fiskale pa e cenuar borxhin publik"*

ARISTIR LUMEZI

**Kryeministri Rama e sheh procesin e rindërtimit të pasojave të tërmetit të 26 nëntorit si proces të rimëkëmbjes me rritje të konsiderueshme ekonomike. Gjatë një bashkëbisedimi me gazetarët, i shoqëruar nga ministri për Rindërtimin, Ahmetaj, dhe ministrja e Financave, Denaj, Rama foli për paketën ekonomike të qeverisë, me të cilën do të shkojë në zgjedhje për të marrë një mandat të ri qeverisës. Temë e këtij takimi ishte rimëkëmbja ekonomike pas tërmetit dhe pandemisë së Covid, kur ai tha se do të kthen në punë edhe 13 mijë personat që humbën punën për shkak të karantinës. Kryeministri përmendi se një nga programet më të rëndësishme në vend është rritja e pagës minimale për punonjësit. Sipas tij, "një nga programet e tjera është edhe raporti i vendit të punës dhe pagës. Do ta bëjmë në javët në vijim, siç e kishim premtuar. Nuk do të jetë nën 300 mijë lekë të vjetër më". Kreu i qeverisë tha dje se do të jetë në këtë detyrë deri në 2025, pra, edhe një mandat të tretë, ndërsa ironizoi dhe opozitën, kur e cilësoi kreun e PD-së shalqi me provë, si të pangrënshëm.**



**RAMA I QUAN MEDIAT PORT'HALE**
Edhe një herë tjetër Kryeministri ka folur me gjuhë joetike ndaj mediave, duke i quajtur ato port'hale. Gjatë komunikimit të djeshëm të Ramës me përfaqësuesit e mediave të thirrur prej tij, ai tregoi edhe një herë afeksionin për kritikën mediatike, e cila nuk përjashton asnjë qeveri. Pas fjalës "kazan", ai e pasuroi fjalorin e tij duke i quajtur "port'hale". "…Por këtë e dinë ata që merren me biznesin e vogël dhe jo ata që këndojnë për shtëpinë diskografike të SHQUIP apo ata që e ndjekin Shqipërinë nga larg përmes kanaleve dhe port'haleve", tha Rama dje gjatë fjalës së tij. "Ne këtu jemi dhe këtu më keni të paktën edhe 5 vjet. Pastaj 2025-2029 flasim".



RINDËRTIMI

Janë 70 projekte të rindërtimit, që janë në zbatim apo në prag të fillimit të zbatimit në Bashkinë e Tiranës, me një vlerë të përgjithshme 80 milionë euro dhe këtu hyjnë banesa, qendra shëndetësore, shkolla etj. dhe me një impakt direkt ekonomik për 17 mijë persona. Projekte, të cilat në fazën e tyre të zbatimit të plotë do të gjenerojnë rreth 15 mijë vende pune.

Në pjesën tjetër të territorit të impaktuar nga tërmeti, Fondi Shqiptar i Zhvillimit është në fazë zbatimi apo në prag të nisjes tani. Kanë mbaruar të gjitha procedurat për rreth 30 projekte të tjera, me një vlerë rreth 62 milionë euro. Edhe këtu, kopshte, shkolla, infrastrukturë dhe përgjithësisht banesa. Në total, kjo impakton direkt jetën e rreth 25 mijë personave. Bëhet fjalë për shumë familje që do të rikthehen në shtëpi. Gjeneron 2 mijë vende pune direkte, pa llogaritur vendet e punës indirekte.

Paralelisht, Agjencia Kombëtare e Planifikimit ka në proces 35 procedura të tjera projektesh, studimesh e projektimesh, 18 zona të reja zhvillimore, 31 pallate, 2235 banesa individuale. Këto të gjitha prekin 33 mijë qytetarë të tjerë.

Këto projekte nga Bashkia Tiranë, ku është dhe një volum i madh investimi që do të implementohet me hapjen e kantiereve në lagjet ku do ndërtohen pallate dhe në pjesën tjetër të zonës së prekur nga tërmeti përmes FSHZH-së, janë gjithë pjesa e luanit, po themi, të Paketës së Rindërtimit, ku hynë edhe pjesa tjetër, ajo e financimeve të donatorëve, ku vetëm Bashkimi Europian si entitet, pa llogaritur shtetet e tjera anëtare, fillon në ditët në vijim injektimin e rreth 100 milionë euro. Brenda gjithë kësaj kini parasysh impaktin në punësim.

Në vitin e ardhshëm, ne parashohim 25 miliardë shtesë, pra, 250 milionë dollarë pak a shumë dhe 6 miliardë në finale në vitin pas vitit të ardhshëm, sepse gjithë ky volum i madh ndërtimesh intensive pallatesh banimi është në një kohë shumë ambicioze për nga shtrirja, por është njëkohësisht edhe një volum që kërkon një injektim të rëndësishëm financiar.

E tërë kjo e bën procesin e rindërtimit një proces rimëkëmbjeje ekonomike, të konkretizuar nga një rritje ekonomike e konsiderueshme në këtë periudhë në vijim. Një gjë është e sigurt dhe këtë e them me shumë krenari që në periudhën afatmesme, duke filluar nga viti që sapo vjen brenda pak muajsh dhe në dy vitet e shtrira, Shqipëria ka paketën më të madhe të investimeve publike në historinë e saj dhe pa cenuar konsolidimin fiskal. Pra, pa e cenuar nivelin e borxhit publik përtej domosdoshmërisë që kemi pasur në këtë fazë dhe që ka prekur borxhin publik të Republikës së Shqipërisë, siç ka prekur borxhet publike të të gjitha vendeve, pa përjashtim.

OPOZITA

Për atë që ju e quani kandidati për Kryeministër, përgjigjka ime është shumë e thjeshtë, është shalqi me provë. Domethënë, i pangrënshëm, sepse nuk është i ardhur nga hëna, por ka qenë në provë disa herë dhe natyrisht, shkuarja në ekstrem me propozime të ashtuquajtura platforma alternative është thjesht shprehje e mungesës së seriozitetit. Të një mungese seriozitetit të provuar në kohën kur këtë vend e qeveriste tjetërkush. E largqoftë të kishte ndodhur që flama e COVID-it ta kishte gjetur këtë vend me atë kandidatin dhe me klubin e asaj të ashtuquajture opozitë e bashkuar në pushtet dhe të kishte gjetur në këtë vend spitalet që gjetëm ne, kur na besuan shqiptarët, shërbimet shëndetësore që gjetëm ne, kur na besuan shqiptarët, kapacitetet profesionale që gjetëm ne, kur na besuan shqiptarët.



**AHMETAJ: SHUMICA E BANESAVE INDIVIDUALE, PARA VITIT TË RI**
Ministri i Rindërtimit, Arben Ahmetaj, duke folur për Planin e Rindërtimit 2020, deklaroi se një pjesë e mirë e banesave do të mbarojnë përpara Vitit të Ri. "Janë edhe 2 mijë përfitues nga njësitë individuale. Janë 143 objekte arsimore që janë financuar nga buxheti i shtetit, në 33 objekte kanë filluar punimet, në 4 pritet të nisin punimet, kemi 92 shkolla nga donatorët. Një pjesë e mirë e banesave individuale mbarojnë më 31 dhjetor 2020. Kemi 92 objekte kolektive që duhen vlerësuar, shembje apo të tjera. Kanë nisur edhe ndërtimet që financohen nga qeveria turke. Brenda 15 tetorit hapen themelet e lagjes '5 maji'", tha Ahmetaj. Ai tha se qeveria ka disa para i ka shpërndarë për rindërtim. "Qeveria ka akorduar 9.44 miliardë lekë, që do të shkojnë në duar të familjarëve, banesat e së cilëve janë me probleme të vogla ose mesatare. Ndërsa 20 miliardë lekë janë shpërndarë. Janë mbi 27 mijë familje që përfitojnë brenda tetorit 2020. Deri tani janë paguar mbi 19 mijë familje dhe në dorë familjet kanë marrë 5.4 miliardë lekë", vlerësoi ai.

Për sa i përket "të kujtuarit", që e kam vënë re në këtë periudhë që është një lloj kënge e porositur nga shtëpia diskografike e SHQUPI-t, që "tani u kujtove të ulësh taksat", në fakt jo, ne jemi kujtuar për uljen e taksave në fund të vitit 2013. Kemi premtuar përgjysmimin e taksës së biznesit të vogël dhe taksimin e ndershëm si alternativë e taksës së sheshtë dhe kemi ulur me paketën e parë fiskale në 2014-ën gjysmë për gjysmë taksën për biznesin e vogël. Por këtë e dinë ata që merren me biznesin e vogël dhe jo ata që këndojnë për shtëpinë diskografike të SHQUIP apo ata që e ndjekin Shqipërinë nga larg përmes kanaleve dhe port'haleve. Këtë nuk mund ta dijë askush tjetër që nuk është interesuar të marrë të vërtetën apo që nuk është drejtpërdrejt i lidhur. Ulja e tanishme që nuk është një premtim, nuk është një "do të". Premtimin e kemi dhënë më parë dhe e kemi dhënë në mos gabohem, përpara sesa të vinte karantina e përgjithshme dhe COVID-i, që në vitin 2029, ne do të garantojmë – natyrisht, deri në 2029, do të garantojmë duke pasur njëkohësisht të drejtën për ta bërë këtë nga shqiptarët, - që nuk do të ketë taksë dhe TVSH për biznesin e vogël. Atëherë u bë premtimi e megjithëse na ra flama si gjithë botës nga COVID-i, në korrik e kemi bërë ligj. Nuk është premtim dhe ne këtë do ta mbajmë ashtu siç është e shkruar në ligj dhe siç e kemi thënë deri në vitin 2029. Kur flas për pagë minimale, nuk flas për pagë minimale në shtet, flas për pagë minimale të imponuar në Republikën e Shqipërisë, pra, në sektorin privat. Sepse dikush shkruante "si mund të punosh me 200 mijë lekë, si mund të punosh me 230 mijë lekë". 300 mijë lekë do të jetë paga minimale e detyruar për çdo kompani private që punëson njerëz apo për çdo të vetëpunësuar në Republikën e Shqipërisë.

PREMTIMET

Fati i mirë në këtë rast për të gjithë është që këta i kemi parë. Pra, nuk është se janë të paparë. Janë të paparë në mënyrën sesi bëjnë sikur nuk i kemi parë, por që ne i kemi parë, janë shalqi me provë. Madje, këta një herë, sidomos këta, Saliu, Luli, Iliri, Monika janë shalqi të provuar disa herë dhe në asnjë nga provat nuk kanë dalë të pjekur, kështu që janë të papjekshëm. Besoj që është brenda përgjigjes, nuk ka kontradiktë në këtë. Ne jemi në një rrugë, ku faktikisht sot po ndajmë me njerëzit frute të punës dhe të përpjekjeve të përbashkëta. Janë punë dhe përpjekje e përbashkët këto frute, pra, nuk është një asfalt elektoral, siç është gjithë programi i ashtuquajtur platformë i Partisë Demokratike. Ai është asfalt elektoral, nga ato asfaltet që hidheshin në kohën e Saliut me daulle e që u dilte boja në shiun e parë pas fushatës. Ato janë si tramvaji i Tiranës, njësoj. Në çdo sektor një tramvaj. Po ku është tramvaji? Me siguri, po të shkoni te SHQUP-i do t'u tregojnë dhe tramvajin kështu që bëni kujdes, merrni maskë me vete.

TAKSA PROGRESIVE

Nuk i kemi pasur dje mundësitë që kemi sot. Nuk mund ta

➔



SITUATA EKONOMIKE

FMN

Fondi Monetar Ndërkombëtar bën parashikime jooptimiste për ekonominë

# FMN: Ekonomia shqiptare në 2020 do tkurret me 7.5%

## *“Plan rezervë nëse pandemia përkeqësohet, ‘jo’ amnistisë fiskale”*

**Përfundimet e FMN-së për 2020-ën**

Ekonomia pritet të tkurret me 7.5% ketë vit, nga -5% që ishte pritshmëria në prill, kur sa kishte nisur pandemia
Kujdes në menaxhimin e projekteve të partneritetit publik privat
Përdorimi i PPP-ve me propozim të pakërkuar duhet të vazhdojë të parandalohet.
Korporata e Investimeve do të jetë një risk i shtuar fiskal
Risku i një pandemie më të rëndë – gatishmëri për t’u përshtatur dhe për të ruajtur stabilitetin
Autoritetet duhet të përgatiten për një rritje të mundshme të kredive me probleme dhe të vijojnë të përmirësojnë kuadrin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme
Një sistem tatimor më i drejtë, më i thjeshtë, më efikas dhe më transparent mund ta fuqizojë mobilizimin e të ardhurave buxhetore, duke përmirësuar ndërkohë klimën e investimeve dhe duke ulur informalitetin.




TIRANE

**Fondi Monetar Ndërkombëtar, në një deklaratë të fundit pas përfundimit të misionit virtual në Shqipëri, ka bërë të ditur se ekonomia pritet të tkurret me 7.5% ketë vit, nga -5% që ishte pritshmëria në prill, kur sa kishte nisur pandemia.**

Fondi ka bërë thirrje për rritjen e të ardhurave dhe një sistem më transparent fiskal, si dhe ruajtjen e stabilitetit financiar, pasi pritet rritje e kredive me probleme. Fondi ka ritheksuar qëndrimin e tij kundër amnistisë fiskale, si dhe ka kërkuar kujdes në menaxhimin e projekteve të partneritetit publik privat (PPP). Fondi shtoi se Korporata e Investimeve do të jetë një risk i shtuar fiskal. Deklarata përmbyllëse përshkruan konstatimet paraprake të ekipit të FMN-së në mbyllje të një vizite virtuale nga një ekip zyrtar (ose “misioni”). Sipas gjetjeve të FMN-së, kërkohet punë shumë e madhe për të ruajtur stabilitetin financiar duke mbështetur ndërkohë huamarrësit e goditur nga krizat. “Ka nevojë për të përgatitur masa rezervë në rast të një pandemie më të rëndë. Kjo pasiguri e paprecedentë e pandemisë nënvizon rëndësinë që ka planifikimi i rezervave. Në rastin e një pandemie më të rëndë, autoritetet do të duhet të marrin masa të reja për të siguruar ofrimin adekuat të kujdesit shëndetësor dhe për të mbrojtur grupet më në nevojë, duke identifikuar mundësitë për rishpërndarje të buxhetit dhe financime shtesë dhe për të mbajtur likuid tregun e brendshëm financiar”, thuhet në raport. Sipas FMN-së, Autoritetet duhet t’i dyfishojnë përpjekjet për të përmirësuar të ardhurat tatimore nëpërmjet ngritjes së një sistemi më të drejtë, më të thjeshtë, më efikas dhe më transparent tatimor, i cili nxit rritjen ekonomike. Fondi i kujton qeverisë që të aplikojë një sistem sa më të thjeshtë taksash. “Një sistem tatimor më i drejtë, më i thjeshtë, më efikas dhe më transparent mund ta fuqizojë mobilizimin e të ardhurave buxhetore, duke përmirësuar ndërkohë klimën e investimeve dhe duke ulur informalitetin”, thuhet në raport. Një rritje e mundshme e kredive të këqija shihet me shumë problem nga Fondi. “Autoritetet duhet të shmangin krijimin e detyrimeve të reja të prapambetura të shpenzimeve buxhetore dhe në rimbursimin e TVSH-së dhe t’i qëndrojë planit për shlyerjen e stokut ekzistues. Këto detyrime të prapambetura, jo vetëm që cenojnë klimën e biznesit dhe besimin te qeveria, por dëmtojnë edhe flukset monetare të bizneseve në një kohë kur tashmë janë nën trysni për shkak të krizave”, thuhet në raport. Misionet kryhen si pjesë e konsultimeve të rregullta (zakonisht vjetore) në bazë të Nenit IV të Statutit të FMN-së, në kuadër të një kërkese për të përdorur burimet e FMN-së (hua nga FMN-ja), si pjesë e diskutimeve të programeve të monitoruara nga ekipi ose si pjesë e monitorimeve të tjera që u bën ekipi zhvillimeve ekonomike. Sipas njoftimit zyrtar, një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), nën drejtimin e zonjës Yan Sun, zhvilloi një vizitë virtuale gjatë periudhës 17-28 shtator 2020, për të zhvilluar diskutimet e Monitorimit të parë Pas Programit (MPP). Procesi i MPP-së është instrument mbikëqyrjeje i rregullt në ato vende që kanë një nivel kredie të pashlyer të FMN-së, në mbi 200 për qind të kuotës. Misionet e MPP-së kanë fokus të veçantë te pikat e dobëta dhe risqet për aftësinë ripaguese ndaj FMN-së.

**Rama shprehet se do të jetë në krye të qeverisë edhe për një mandat**

# Kreu i Qeverisë: Këtu do më keni deri në 2025

## *“Kandidati për Kryeministër, shalqi me provë, i pangrënshëm”*

←

ulnim dje në zero as tatimfitimin për biznesin e vogël, as TVSH-në. Fakti që sot e bëjmë nuk ka lidhje që po vijnë zgjedhjet. Ky ka qenë synim i kahershëm dhe ka lidhje me faktin që kemi krijuar mundësi. Pra, rrisim mundësitë dhe hedhim hapa të tjerë në këtë funksion. Përndryshe, nëse do kishim bërë të gjithë këto gjëra që po bëjmë sot, menjëherë pasi fituam, do kishim qenë magjistarë, por kjo nuk është e mundur. Për sa i përket taksës progresive, po, jemi duke bërë një plan dhe sapo ta kemi gati do ta ndajmë me ju. Edhe aty me synimin që të lehtësojmë barrë të atyre që jetojnë me punë, flas për ata që jetojnë me një pagë dhe njëkohësisht që të rrisim fuqinë blerëse të gjithsecilit, aq sa të jetë e mundur, kudo ku të jetë e mundur, kurdo që është e mundur. Përndryshe, me platforma të krijuara e të trumbetuara në kushtet kur nuk ke asnjë përgjegjësi, kur nuk mban asnjë përgjegjësi dhe kur edhe e di që shanset që ta japin atë përgjegjësi i ke minimale e prandaj lëshohesh si Sudja dhe si Vebiu për të kapur, çfarë të kapësh, Shqipëria nuk bën përpara, bën vetëm mbrapa. Shqiptarët e kanë shumë të qartë, shalqinjtë me provë që kanë rezultuar kunguj nuk ka shans t’i blejnë për shalqi të ngrënshëm.

**RRITJA E PAGAVE**

Ka dhe një ndryshim më të madh akoma, midis rritjes së pagës për mjekët dhe infermierët deri në 40% që do ta bëjmë ne dhe do të jetë e shkruar e do të miratohet me ligj në Kuvendin e Shqipërisë dhe idesë se mund të shkojnë pagat 1200 euro, se mund të shkojnë subvencionet 150 milionë euro për bujqësinë, se mund të shkojnë ku di unë se çfarë, 100 këtu, 100 atje, 200 atje, 300 atje dhe se mund të bëhet deti kos. Jo! Të rrisësh pagat në këto kushte, deri në 40% për mjekët dhe infermierët dhe në mënyrë të konsiderueshme edhe për mësuesit, të rrisësh pagën minimale 300 mijë, të heqësh fare tatim fitimin dhe TVSH-në dhe të mbash financat nën kontroll, duke e konsoliduar aspektin makroekonomimk të vendit, kjo është qeverisje. Kurse të hapësh thesin se po vijnë zgjedhjet, duke hapur gojën e duke lëshuar për të gjithë lugët e floririt është thjesht për të qeshur. Kështu që, nuk ka asnjë krahasim, asnjë mundësi krahasimi sepse i kemi parë.

**AMNISTIA FISKALE**

Kam dhënë më shumë se një provë që unë edhe tërhiqem kur ka arsye për t’u tërhequr, por këtu nuk ka arsye për t’u tërhequr, ka arsye për të punuar me durim dhe për të bashkëpunuar me të gjithë strukturat ndërkombëtare, për të arritur në një draft, në këtë rast konsensual me ta. Konsensusi 100% për drafte të brendshme nuk është i detyrueshëm. Në këtë rast është i detyrueshëm, deri kur do them jo, por do themi OK, nuk arritëm 100%, por do të shkojmë përpara. Por për momentin jemi duke bashkëpunuar shumë mirë me një sërë strukturash ndërkombëtare. Kështu që kuptohet në këtë rast nuk mund t’i vëmë vetës një afat, të themi një apo dy muaj, sepse varet edhe nga ata. Ata kanë edhe punë të tjera.




**TABAKU: KRYEMINISTRI GËNJEN PËR PLANIN E RIMËKËMBJES**

Duke kujtuar deklaratat e Kryeministrit Rama për planin kombëtar të rimëkëmbjes, ish-deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, numëron listën e premtimeve të bëra, që, siç thekson ajo, janë vetëm një vijim gënjeshtrash. Teksa ka publikuar një video në “Facebook”, Tabaku numëron ato që i cilëson kolona e gënjeshtrave dhe mashtrimeve të Ramës. “Kolona e gënjeshtrave dhe mashtrimeve vijon! E frikshme se si një Kryeministër shpik një program dhe e pagëzon si ‘Plani Kombëtar i Rimëkëmbjes Ekonomike’ vetëm për ta instrumentalizuar si gënjeshtrën e radhës. Askush nuk pret më asgjë nga ky sharlatan i pacipë që nuk kursen askënd, në shërbim të oborrit të tij, mbjellë me gënjeshtra, premtime boshe dhe korrupsion”, shkruan ish-deputetja Tabaku.

KANDIDATET E PD

VOTIMI

### Për të skualifikuar një kandidat nga gara duhen 20% të votave kontestuese

# Kandidatët e PD, demokratët e Shkodrës votojnë sot 39 emrat

## *Nga Bardh Spahia, Izmira Ulqinaku, Romeo Gurakuqi te Voltana Ademi, kush kërkon rikonfirmim nga anëtarësia për të vazhduar garën*



Mariglen Kume

**Demokratët e qarkut të Shkodrës votojnë sot për kandidatët e propozuar nga anëtarësia, të cilët kanë kaluar filtrin paraprak të verifikimit nga Komisioni i Vlerësimit të Kandidatëve.**

Në këtë qark 5-shja e komisionit ka vlerësuar si të përshtatshëm për t'u sprovuar në anëtarësi 39 individualitete që synojnë të përfaqësojnë PD-në në zgjedhjet e përgjithshme në 2021-shin dhe për pushtetin lokal. 23 kandidatë kanë kaluar filtrin paraprak në komisionin e skualifikimit vetëm në degën Shkodër të qarkut Shkodër. Në degën Vau i Dejës komisioni ka çuar për t'u votuar nga anëtarësia 4 kandidatë, në Malësinë e Madhe 5 kandidatë dhe në degën e Pukës 7 kandidatë. Qarku i Shkodrës arrin që të çojë në Parlament gjithsej 11 ligjvënës.

PROCESI

Skema që po praktikon selia blu për të zgjedhur "kalorësit" e saj të betejës për të siguruar maxhorancën në zgjedhjet e ardhshme ka hyrë në fazën e tretë të saj. Në fazën e parë demokratët propozuan rreth 3600 emra. Ndërkohë, komisioni i posaçëm i ngritur në selinë blu kaloi për në fazën e dytë 1000 emra. Në fazën e dytë të procesit kandidatët i janë nënshtruar "vettingut" nga 5 anëtarët, Besnik Mustafaj, Bujar Nishani, Genc Ruli, Mark Marku dhe Enriketa Papa. Përreth një muaj komisioni ka bërë verifikimin e pastërtisë së figurës së kandidatëve, ku nga 1000 emra që kaluan në fazën e dytë, në fazën e tretë kanë kaluar vetëm 400 emra. Pas përfundimit të procesit të konsultimit me anëtarësinë, kandidatët e konfirmuar i nënshtrohen vlerësimit përfundimtar të Komisionit në fazën e tretë. Anëtarët e komisionit votojnë bazuar, kryesisht, në vlerësimin e performancës politike të kandidatit dhe mundësinë e maksimalizimit të votës. Pas këtij vlerësimi përfundimtar, lista me kandidatët që kalojnë fazën e tretë i dorëzohet për vendimmarrje finale kryesisë së Partisë Demokratike. Votimi i konsultimit të anëtarësisë ka përfunduar në qarkun e Kukësit, Dibrës, Gjirokastrës dhe Beratit. Procesi po ndiqet nga afër nga Sekretari i Përgjithshëm, Gazment Bardhi, dy nënkryetarët Edi Paloka dhe Edmond Spaho, Sekretari Organizativ Sahit Dollapi dhe Sekretari i Burimeve Njerëzore, Ervin Minarolli. Ndërkohë, vlen të theksohet se komisioni i vlerësimit në PD, përveç kandidatëve të rinj, ka vendosur që të masë se sa të dashur janë nga anëtarësia edhe anëtarët e kryesisë së selisë blu. Kështu, për votim, njësoj si kandidatët e rinj, do të shkojë edhe kryesia. Shumica e tyre do të votohen nga anëtarësia e PD-së në kryeqytet, të shpërndarë sipas degëve. Mirëpo kjo nuk do të thotë se në listën finale do të jenë në kryeqytet. Nga procesi i votimit përjashtohet kryetari i PD-së, sekretari i përgjithshëm dhe dy nënkryetarët.

### PLATFORMA

**DEGA SHKODËR**

1. ARBEN GJURAJ
2. ARTAN HAXHI
3. BARDH SPAHIA
4. BASHKIM RROJI
5. BENARDETA SYKU
6. BLENDI GJYLBEGAJ
7. EMILJANO PJETRI
8. FLORIAN BJANKU
9. GRETA BARDELI
1. HELGA SALLAKU
11. HELIDON BUSHATI
12. IMELDI SOKOLI
13. IZMIRA ULQINAKU
14. LEDINA MANDIJA
15. LORENC LUKA
16. MARK RUPA
17. NDOC ASHTA
18. NESTI KIRI
19. NEVILA BUSHATI
20. RAMIZ ÇOBAJ
21. ROMEO GURAKUQI
22. VOLTANA ADEMI
23. XHEMAL BUSHATI

**DEGA VAU I DEJËS**

1. GJOK ULDEDAJ
2. MARIN TUKAJ
3. PJETER LLESHI
4. ZEF HILA

**DEGA MALËSI E MADHE**

1. ALDO GEGA
2. AUREL MARKAJ
3. ERMIRA ÇOBAJ
4. FATBARDH ZEKAJ
5. RAMADAN LIKA

**DEGA PUKË**

1. ANTONETA ZAJA
2. GEZIM VATA
3. HIL KOLA
4. LODOVIK HASANI
5. NDOC FASLIA
6. PREL GJONI
7. RROK DODA




BASHA, DJE GJATE PREZANTIMIT TE PROGRAMIT

### LEZHA VOTON MË 1 TETOR

*Sipas kalendarit të votimeve të publikuar pak ditë më parë nga selia blu, sot votojnë demokratët e Shkodrës, ndërsa më 1 tetor do të jenë demokratët e Lezhës që do të vendosin nëse do të konfirmojnë në bllok listën që do të vijë nga selia blu apo do të kenë kandidatë më pak të preferuar. Pas Lezhës do të ketë sërish një ditë pushim dhe më pas votimet do të zhvillohen më 3 tetor në qarkun e Durrësit, një ditë më pas votimi bëhet në Elbasan dhe më 5 tetor vendosin demokratët e qarkut të Vlorës. Të djathtët e Korçës do të votojnë më 7 tetor për kandidatët e tyre dhe më pas Fieri dhe Tirana. Ndërkohë, për dy qarqet e fundit komisioni i skualifikimit, i përbërë nga 5-shja, Besnik Mustafaj, Bujar Nishani, Genc Ruli, Mark Marku dhe Enriketa Papa, nuk kanë ende gati të gjithë emrat që do t'u çojnë për konsultim anëtarëve të djathtë në qarkun e Tiranës*

**NJOFTIM ANKANDI**

**Zyra Përmbarimore Private "REAL BAILIFF SERVICE" Sh.p.k** do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të llojit **"Tokë Pemëtore"** me sip. totale 1700 m2, Nr. pasurie 441/16, Vol.7, Faq. 207, ZK 1921, në pronësi të Kadri Xhemal Voga dhe Nafie Isen Voga me adresë Halil, Krujë, Regjistruar në Agjencia Shtetërore e Kadastres Drejtoria Vendore Krujë, mbi të cilën është vënë hipotekë në favor të "Agrokredit" Sh.a, Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është në vlerën **4,335,000 (katër milion e treqind e tridhjete e pesë mijë) LEKË.**
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Zyrës Përmbarimore Private "REAL BAILIFF SERVICE" sh.p.k, në **datë 14.10.2020 në orën 16:00**, në adresën: Rr. "Pjetër Bogdani", Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.

**NJOFTIM ANKANDI**

**Zyra Përmbarimore Private "REAL BAILIFF SERVICE" Sh.p.k** do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të llojit **"Arë",** me sip. 2,000 m$^2$, Nr. pasurie Nr.369/12, Vol.9, Faqe 161, ZK 1921, në pronësi të Kadri Xhemal Voga dhe Nafie Isen Voga me adresë Halil, Krujë, Regjistruar në Agjencia Shtetërore e Kadastres Drejtoria Vendore Krujë. Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është në vlerën **5,100,000 (pesë milion e njëqind mijë) LEKË.**
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Zyrës Përmbarimore Private "REAL BAILIFF SERVICE" sh.p.k, në **datë 14.10.2020 në orën 16:00**, në adresën: Rr. "Pjetër Bogdani", Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.

**NJOFTIM ANKANDI**

**Zyra Përmbarimore Private "REAL BAILIFF SERVICE" Sh.p.k** do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të llojit **"Apartament",** me sip. 55,3 m$^2$, ZK Nr.8525, Nr. Pasurie 3/2 + 1 - 12, Vol.8, Faqe 244, me adresë: Lagjia "Haxhisa", pallati 596/1, shkalla 1, Kati 4, ap, 12, Elbasan, në pronësi të Marjeta Thoma Dido dhe Yllson Zenel Dido, regjistruar pranë ASHK Elbasan, mbi të cilën është vënë hipotekë në favor të "Agrokredit" Sh.a, Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është në vlerën **2,856,000 (dy milion e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) LEKË.**
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Zyrës Përmbarimore Private "REAL BAILIFF SERVICE" sh.p.k, në **datë 26.10.2020 në orën 16:00**, në adresën: Rr. "Pjetër Bogdani", Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.

**NJOFTIM ANKANDI**

**Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service"**me Përmbarues Gjyqësor Enuar Merko njofton se më **datë 21.10.2020, ora 8:00-16:00** në ambientet e saj do të zhvillojë ankandin e dytë për shitjen e pasurisë të paluajtshme, në pronësi të hipotekuesit Islam L. Beshku me vlerën fillestare në masën prej **84'000 (tetëdhjet e katër mijë) EURO.** Pasuria është e llojit **"Arë"** me sipërfaqe totale 2500 m$^2$, nr.pasurie 182/59, vol.17, fq.112, zk.2679 e ndodhur në Mëzez, Tiranë.
Për çdo informacion mund të paraqiteni pranë Zyrës Përmbarimore "E.G BAILIFF SERVICE" me Përmbarues Gjyqësor Enuar V Merko në adresën Rr. "Themisokli Gërmenji", Pallati "Ambasador 1", Kati 2, Tiranë, ose të kontaktoni në Cel.0672027580;
e-mail: enuar.merko@gmail.com;

**NJOFTIM ANKANDI**

**Zyra Përmbarimore "E.G BAILIFF SERVICE"** me Përmbarues Gjyqësor Enuar Merko njofton se më **datë 19.10.2020, ora 8:00-16:00** në ambientet e saj do të zhvillojë ankandin e tretë për shitjen e pasurive të paluajtshme, në pronësi të debitorit Shoqëria "QERAMIKA ALBANIA" sha në vlerën fillestare prej **1'008'000 (një milion e tetë mijë) EURO** e llojit **"Arë"**, me sip.18,192 m$^2$, nr.pasurie 85/42, zk. 1538, vol. 20, fq. 115, me adresë Drenovë, Korçë dhe pasurinë e paluajtshme të llojit **"Truall",** plus **"Ndërtesë"** me sip.14,874 m$^2$ , nga të cilat ndërtesë me sip 8152.6 m$^2$ nr.pasurie 85/41, zk. 1538, vol. 20, fq. 114, me adresë Drenovë, Korçë.
Për çdo informacion mund të paraqiteni pranë Zyrës Përmbarimore "E.G BAILIFF SERVICE" me Përmbarues Gjyqësor Enuar V Merko në adresën Rr. "Themisokli Gërmenji", Pallati "Ambasador 1", Kati 2, Tiranë, ose Cel.0672027580; e-mail: enuar.merko@gmail.com;

**NJOFTIM ANKANDI**

**Përmbarues gjyqësor privat Artan Sima** në **datë 09/09/2020, ditën e premte, ora 16:00** zhvillon ankandin e tretë për shitjen e pasurisë së llojit **"Apartament"** me sipërfaqe 82.80 m$^2$, Nr/pas 3/197 +1-12, Zk 8564, V.24, fq. 217, në emër të shtetasit në cilësinë e debitorit Izet Skënder Jalli e ndodhur në lagjen 17, Rruga "Ajet Xhindolli", pll.10, H.12, k.4, Korçë, me çmim **2,016,000 lekë**.
Vendi ku do të zhvillohet ankandi është salla e mbledhjeve të Përmbaruesit Gjyqësor Privat Artan Sima me seli në Korçë e cila gjendet në adresën: L. 3, Rr. "Avni Rustemi", Nr 31, k.1, Korçë.




RIMEKEMBJA E EKONOMISE

OPOZITA

"1 mijë euro bonus për mjekët e 500 për infermierët, për 6 muaj"

# Rimëkëmbja e ekonomisë, PD publikon planin me 5 pika që duhet të zbatojë qeveria

## Basha: Çek 1 mijë euro në muaj për çdo biznes të vogël, 20 mijë lekë kompanisë për pagën e çdo punonjësi të ripunësuar pas pandemisë

*Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, i vuri në dispozicion dje Kryeministrit Rama një paketë planesh me 5 pika dhe i kërkoi atij që t'i zbatojë në mënyrë që të rimëkëmbet ekonomia nga pasojat e pandemisë së Covid-19. Pa kaluar 10 ditë nga takimi me ekspertët e shëndetësisë, arsimit dhe ekonomisë, kreu i selisë blu u shfaq dje në krah të 14 personaliteteve të PD-së, të cilët, secili sipas fushës së tyre, kanë hartuar masat që duhet të marrë qeveria duke filluar nga shëndetësia, punësimi e biznesi dhe deri tek arsimi në mënyrë që të përballohen pasojat e Covid-19. Disa nga kërkesat e demokratëve për qeverinë ishin rritja e numrit të testimeve deri në 2500 testime në ditë për Covid, rimbursim të plotë për medikamentet e pacientëve të infektuar që trajtohen në shtëpi, si dhe bonus 1 mijë euro në muaj për mjekët e 500 euro për infermierët, në 6 muajt e ardhshëm. Sa i përket arsimit, në paketën e saj PD-ja kërkon që të testohen periodikisht mësuesit, vaksinim në masë nga gripi stinor dhe ujë të rrjedhshëm në shkolla. Bllokimi i aktivitetit ekonomik në disa sektorë të ndryshëm shkaktoi mjaft dëme në ekonomi, probleme që po thellohen edhe më shumë. Për të parandaluar këtë situatë dhe për të rimëkëmbur ekonominë, PD propozon marrjen e masave në disa drejtime. Si fillim, shteti, sipas selisë blu, duhet të mbështesë me pagë që siguron minimumin jetik të atyre që humbasin punën. Për të gjitha këto masa, Basha tha dje në konferencën për shtyp se kostoja është 312 milionë euro në tre muaj. Para që buxheti i shtetit i ka sipas tij, nëse anulohen koncesionet korruptive.*

LULZIM BASHA

Detyra jonë nuk është vetëm të tregojmë problemet, jemi këtu për të prezantuar planin për rimëkëmbjen me pesë hapa kundër krizës, e cila është përgjigjja që ne do t'i jepnim situatës nëse do të ishim në krye të qeverisë dhe ftesa që i bëjmë qeverisë në këta 6 muajt e fundit. Mbështetje dhe përgatitje e sistemit shëndetësor, i cili është hartuar nga specialistët më të mirë. Një plan i detajuar me katër pika kryesore. Rritja me 2500 testime në ditë. Jemi me vendin me numrin më të ulët të testimeve, kjo është recetë për katastrofë. Rimbursimi i plotë për mjekimin ambulator për të sëmurët me Covid. Asgjë që iu nevojitet për t'u kuruar nuk rimbursohet nga shteti. Pika e tretë ka të bëjë me pajisjet mbrojtëse për të gjithë personelin shëndetësor. Mjekët e familjes dhe spitalet janë në gjendje emergjence për pajisjet mbrojtëse. Është bërë një spital i tretë Covid fantazmë, vetëm me mure të lyera dhe nuk është gati për një valë të tretë. Pika tjetër është 1 mijë euro për mjekët dhe 500 euro për çdo infermier, për 6 muajsh e ardhshëm. Meqë ka zgjedhur terminologjinë e luftës, ushtrinë e rraskapitur në 6 muaj përpjekje ta motivojë dhe ta përgatisë për atë që po vjen. Çdo mjek duhet të marrë bonusin e premtuar prej 1 mijë eurosh dhe çdo infermier prej 500 eurosh.

**MBROJTJA E MËSUESVE DHE E NXËNËSVE NGA COVID-19**

Hapja e shkollave ka rezultuar një katastrofë. Objektivi kryesor duhet të jetë që fëmijët dhe mësuesit të jenë të sigurt, duke siguruar kushtet sanitare, dezinfektimin e shkollave dhe të sigurohen maskat dhe dezinfektuesit. Është urgjente që këto kosto të mbarten nga shteti. Duhet të sigurohen pajisjet mbrojtëse falas. Duhet të ketë ujë të rrjedhshëm në të gjitha shkollat.

**PËR BIZNESIN**

Pika katër ka të bëjë me biznesin e vogël, shtylla kurrizore e ekonomisë shqiptare, i goditur më rëndë. Për të gjitha bizneset e vogla, një çek prej 1 mijë eurosh. Sa i përket biznesit prodhues dhe punëdhënësit e mëdhenj, dy masa: heqja e taksës së pronës dhe masa e dytë, shtrirja në kohë dhe rikonceptimi i kritereve të përfitimit nga të dyja skemat e garancisë sovrane, për ta bërë më të aksesueshme dhe të përballueshme kredimarrjen nga biznesi. Përcaktimi i një tavani prej 2% të normës së interesit për biznesin, duke subvencionuar çdo përqindje mbi këtë vlerë në kredimarrjen për investime dhe shpenzime operative. Nëse këto masa nuk merren siç kërkojmë me forcë dhe jo thjesht rekomandojmë për shkak të papërgjegjshmërisë, atëherë përgjegjësia është e gjitha e qeverisë dhe e Kryeministrit për këta 6 muaj që i kanë mbetur.

**KOSTOJA NË BUXHETIN E SHTETIT**

Edhe po të mos ishte gjendja e pandemisë, situata e shëndetësisë dhe ajo në ekonomi kërkojnë masa emergjente, sot më shumë se kurrë, sot më shumë se 3 muaj më parë, se 4 muaj më parë. Ju e mbani mend fare mirë paketën e propozuar atëherë. Kostoja e saj shkonte 90 milionë euro, ndërsa masat që ne propozojmë për 6 muajt e ardhshëm përllogariten në 52 milionë euro në muaj. Pra, efekti total është afro 312 milionë euro për 6 muajt e ardhshëm, duke nisur nga tetori. Kjo përbën 2.45 të prodhimit të brendshëm të Shqipërisë dhe e vendos vendin tonë në mesataren e shpenzimeve të rajonit.

### PLANI PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE

**PIKA E PARË E PLANIT**

**1. Mbështetje dhe përgatitje e sistemit shëndetësor: Përgatitja për një shpërthim tjetër të infeksionit të COVID-19, duke:**

a)Rritur numrin e testimeve për COVID në 2500 testime në ditë.

b)Rimbursim i plotë për marrjen e mjekimit ambulator kundër COVID.

c)Sigurimin e pajisjeve mbrojtëse për të gjithë personelin shëndetësor dhe rritjen e kapaciteteve spitalore.

d)Bonus 1000 euro për çdo mjek dhe 500 euro për çdo infermier për 6 muajt e ardhshëm.

Pika e dytë e planit

**2. Fëmijët tanë të arsimohen të sigurt: Të garantojmë që fëmijët dhe mësuesit në shkollë të jenë të sigurt, duke:**

a)Përmirësuar kushtet sanitare në shkolla duke përfshirë furnizimin me ujë, pajisjen me maska mbrojtëse dhe dezinfektimin e rregullt të ambienteve mësimore.

b)Kryer testimin periodik për mësuesit dhe stafin ndihmës.

c)Investuar në teknologji për rastet kur mund të aplikohet mësimi në distancë, përfshirë ndihmën për familjet me të ardhura të ulëta për të blerë tableta për fëmijët e tyre, në mënyrë që edhe ata të përfitojnë nga mësimi në distancë.

Pika e tretë e planit

**3. Asnjë shqiptar të mos lihet pas dore:**

a)Të mbështesim ata që kanë humbur vendin e punës. Çdo individ që ka humbur vendin e punës nga pandemia gjatë këtij viti, të përfitojë një çek mujor prej 16 mijë lekësh të rinj në muaj, përveç pagesës ligjore për papunësinë, për një periudhë prej 6 muajsh.

b)Krijimi i një fondi të punësimit për të mbështetur bizneset për të rimarrë në punë të larguarit gjatë pandemisë, duke i alokuar çdo punëdhënësi që rimerr në punë një individ që ka humbur vendin e punës prej pandemisë, një shumë mujore prej 20 mijë lekësh të rinj në muaj për një periudhë prej 6 muajsh.

c)Dyfishimi i ndihmës ekonomike për çdo familje që trajtohet me ndihmë ekonomike.

d)Çdo pensionist të përfitojë një çek mujor prej 2 mijë lekësh të rinj në muaj për përballimin e kostove shtesë të pandemisë, për 6 muaj.

Pika e katërt e planit

**4. Ndihmë për biznesin e vogël: Mbështetje e drejtpërdrejtë për të gjitha bizneset e vogla të prekura nga pandemia. Çek prej 1000 eurosh për çdo biznes të vogël aktiv.**

**5. Mbështetje për biznesin prodhues dhe punëdhënësit e mëdhenj:**

a)Për 6 muajt e ardhshëm, subvencionim 50% të qirasë për ambientet e punës ose heqje e taksës së pronës për bizneset pronare të ambienteve të punës.

b)Shtrirja në kohë dhe rikonceptimi i kritereve të përfitimit nga të dyja skemat e garancisë sovrane, për ta bërë më të aksesueshme dhe të përballueshme kredimarrjen nga biznesi. Përcaktimi i një tavani prej 2% të normës së interesit për biznesin, duke subvencionuar çdo përqindje mbi këtë vlerë në kredimarrjen për investime dhe shpenzime operative.



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

Akuza



## Teliti: Në 7 vite, Rama ka shkelur mbi shqiptarët

**Eksperti i ekonomisë në Partinë Demokratike, Dorian Teliti, ka reaguar pas njoftimit të Kryeministrit Edi Rama se nuk do të ketë më inspektime në biznesin e vogël. Teliti shkruan se biznesi i vogël tashmë është shkatërruar totalisht, ndërsa Rama është ai që për 7 vjet ka shkelur mbi mundin dhe djersën e shqiptarëve të ndershëm që punojnë çdo ditë. "Iku kasa bashkë me inspektorët! Po për çfarë do t'i duhen tani kasat e tenderuara? Thjesht për të mbush xhepat me vjedhjen e radhës! Sa për biznesin e vogël, atë e ka shkatërruar totalisht. Kjo është fytyra e gënjeshtarit kronik. Ky është ai që për 7 vjet ka shkelur mbi mundin dhe djersën e shqiptarëve të ndershëm që punojnë çdo ditë. Koha që ta largojmë të keqen po afron", shkroi Teliti.**

SHEMBJA E TEATRIT

HETIMET

Prokuroria Speciale shkrin 6 paditë për shembjen e Teatrit Kombëtar

# SPAK nis marrjen në pyetje për shembjen e Teatrit, Meta: Koha për drejtësi!

## *Presidenti: "Akti taleban i shembjes së Teatrit, i paamnistueshëm!" Basha: "Teatrin Kombëtar do ta rindërtojmë siç ishte, aty ku ishte"*

ARDIT HOXHA

**Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion ka filluar marrjen në pyetje të të gjithë personave të përshirë në çështjen e shembjes së godinës së Teatrit Kombëtar mëngjesin e 17 majit.**


Gjatë shembjes së godinës së Teatrit Kombëtar

SPAK e ka nisur procedurën duke marrë në pyetje fillimisht avokaten Adriana Kalaja, e cila është një nga personat që ka dorëzuar padi në SPAK për procedurat që janë ndjekur nga qeveria dhe Bashkia Tiranë para dhe pas shembjes së godinës historike. Pas avokates Kalaja do të merren në pyetje edhe personat e tjerë të përfshirë në këtë çështje. Ndërkohë mësohet se SPAK ka bërë shkrirje të gjashtë padive që janë dorëzuar nga Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit. Padi në SPAK ka depozituar edhe Presidenti Meta gjatë muajit maj. Hetimet për shembjen e godinës së Teatrit nisën më 21 maj dhe prokurori i çështjes, Ervin Kondilli, sekuestroi dokumentet nga Bashkia Tiranë për procedurën e ndjekur për shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar dhe asaj të Teatrit Eksperimental "Kujtim Spahivogli".

**PRESIDENTI**

Pas nisjes së marrjes në pyetje të personave të përfshirë në çështjen e shembjes së Teatrit Kombëtar reagoi Presidenti Meta. Ky i fundit, shembjen e Teatrit Kombëtar bashkë me dëmtimin e vlerave arkeologjike në Durrës i cilësoi si krime që nuk do mund të amnistohen dhe theksoi se shumë shpejt do të vijë koha për drejtësi. "Akti taleban i shembjes së Teatrit Kombëtar, shkatërrimi i shumë vlerave unikale arkeologjike në Durrës dhe dëmtimi i disa monumenteve në mbarë vendin janë dëshmitë ulëritëse më të freskëta se si arroganca, korrupsioni dhe papërgjegjshmëria e një pushteti mund të sjellë dëme të pariparueshme për trashëgiminë tonë kombëtare e kulturore, pjesë e trashëgimisë europiane. Të gjitha këto krime të rënda kushtetuese, ligjore dhe morale, të konsumuara veçanërisht në Tiranë dhe Durrës, ku dëmet kanë qenë të jashtëzakonshme, do të jenë të paamnistueshme! Sepse këto akte barbarie, për më tepër të kryera nga institucionet shtetërore, janë sulme të drejtpërdrejta ndaj identitetit tonë kombëtar. Ndaj, sot, në Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, i garantoj të gjithë shqiptarët se gjithçka është mbajtur shënim dhe askush nuk ka për t'i shpëtuar drejtësisë. Duke kujtuar profesor Paolo Vittin, i cili me të drejtë thotë se: "Europa nuk është vetëm euro, por edhe kulturë, solidaritet, humanizëm dhe identitet", risjell edhe një herë në vëmendje qëndrimin e "Europa Nostra" në lidhje me shembjen e Teatrit Kombëtar: "Le të jetë kjo ngjarje e mjerueshme ajo që do të shënojë fillimin e një zgjimi të vërtetë të shoqërisë civile në Shqipëri, të udhëhequr nga artistë dhe intelektualë". Barbaria dhe talebanizmi nuk kanë vend në shoqërinë tonë. Koha për drejtësi!", shkroi Meta.

**6 PADI** që janë depozituar në SPAK nga Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar janë shkrirë nga prokurori që ka marrë përsipër këtë çështje.

> Meta: Akti taleban i shembjes së Teatrit Kombëtar, shkatërrimi i shumë vlerave unikale arkeologjike në Durrës dhe dëmtimi i disa monumenteve në mbarë vendin janë dëshmitë ulëritëse më të freskëta se si arroganca, korrupsioni dhe papërgjegjshmëria e një pushteti mund të sjellë dëme të pariparueshme për trashëgiminë tonë kombëtare e kulturore

**KREU I PD**

Duke kujtuar Ditën Ndërkombëtare të Trashëgimisë Kulturore, kreu i PD-së, Lulzim Basha, ka vënë theksin te shembja e Teatrit Kombëtar. Për liderin e opozitës, ai akt është një dëshmi e urrejtjes së qeverisë ndaj vlerave dhe se ata që e kryen atë do të mbajnë përgjegjësi para drejtësi. "Këtë vit, Dita Ndërkombëtare e Trashëgimisë Kulturore e gjen Shqipërinë pa Teatrin Kombëtar, që u shemb nga regjimi si dëshmi e barbarisë dhe urrejtjes që kjo qeveri ushqen për vlerat dhe institucionet e kombit tonë. Teatri Kombëtar nuk ishte thjesht një institucion i kulturës dhe një gjurmë elegante e trashëgimisë sonë. Falë rezistencës së artistëve, aktivistëve, intelektualëve dhe qytetarëve të Tiranës, ai u shndërrua në një vijë ndarëse ndërmjet regjimit dhe qytetarisë. Rikonfirmoj angazhimin tim personal dhe të Partisë Demokratike se Teatrin Kombëtar do ta rindërtojmë siç ishte, aty ku ishte dhe ata që e sulmuan dhe e shembën brutalisht do të dalin përpara drejtësisë për këtë krim të rëndë ndaj kulturës, qytetarisë dhe mënyrës tonë të jetesës", shkroi Basha.

**Në muze çelet ekspozita e pazakontë**



## Dita Kombëtare e Trashëgimisë kujtohet përmes 100 fotografive

*Një ekspozitë me 100 fotografi që rrëfejnë Shqipërinë turistike në muajt korrik e gusht vesh muret e Muzeut, përmes imazheve sa spontane, aq edhe artistike të monumenteve, kalave, liqeneve, kishave vendase etj.*

*Autorët e pamjeve të ekspozuara në "Promovo trashëgiminë përmes fotografisë" kanë fiksuar copëza të vendit gjatë pandemisë, pas hapjes së parqeve dhe muzeve. Të përzgjedhurit janë mbi 30, ku pjesa më e madhe fotografive është realizuar nga Ilir Minga. Ndërsa imazhet e tjera u jetësuan nga Auron Zaka, Flavia Selmani, Dori Lame, Xhem Hoxha, Najada Velcani, Klement Sina, Sonjela Babaliu, Renis Hyka, Miklor Pasku, Andi Cimo, Elona Beqiraj etj., mes të cilëve nuk mungojnë as profesionistët.*

*Perëndimi "i flaktë" në Kalanë e Shkodrës, fiksuar nga Armando Meta, dy imazhet mbresëlënëse të Urës së Golikut nga Silvia Yryku, si dhe fotografia meditive "tetë a tetë" e Fjoralba Golikjas me Dean e Butrinit realizuar në Parkun Kombëtar të Butrintit (imazhi përfaqësues i Ekspozitës), janë vetëm disa nga panoramat joshëse të vendit që ofrohen në këtë ekspozitë. Rrugëtimi fotografik nis me Gjirokastrën dhe Vlorën, për të vijuar me qytetet e tjera si Korça, Berati, Shkodra, Kruja etj.*

*Kështu, krahas fotografive të ndryshme që fiksojnë Kalanë e qytetit të gurtë, vijnë edhe tri imazhe të Banesës së Ismail Kadaresë, realizuar në kënde të ndryshme.*

*Fotografitë e shkrepura nga amatorë, për turistët vendas e të huaj që ia befin në ekspozitë zbulojnë edhe një pjesë jo shumë të njohur të vendit, me objekte, parqe, monumente, pasuri natyrore etj. Ekspozita ofron një sërë fotosh të disa prej manastireve në vend, duke nisur nga ai i "Shën Marisë" në Zvërnec të Vlorës, ansamblin monumental në Manastirin e Shën Kozmait në fshatin Kolkondas të Fierit, Manastiri i Shën Kollit në Mesopotami me mjeshtërinë e arkitekturës bizantine, Manastiri "qëndrestar" i 40 shenjtorëve në Sarandë, Manastiri bizantino-ortodoks i Ardenicës etj. Qytetet antike, si ai i Finiqit, Bylisit, Adrianopolisit apo i Butrintit, në imazhet e jetësuara tek-tuk zbulojnë ndonjë grup të vogël turistësh gjatë kësaj periudhe pandemie, që në momentet e fotos ka harruar rregullat e distancimit. Në një kënd të veçantë të ekspozitës, "ngre krye" edhe Ulpiana antike (i ashtuquajturi qyteti "nën dhe") i njohur si një prej qendrave më të pasura të arkeologjisë në Kosovë. Fotoja është realizuar nga Shaqir Foniqi dhe është një nga të paktat që shtrihen jashtë kufijve të Shqipërisë-shtet.*

*Në promovimin e trashëgimisë kulturore vendase "nga qytetarët për qytetarët" nuk mund të mungonin as kalatë, si rrëfimtaret triumfatore të arkitekturës e historisë sonë. Kështu, ndjellin vëmendjen e vizitorëve përmes fotografive Kalaja e Gjirokastrës, ajo e Himarës, e Sopotit në Borsh, Kalaja e Beratit, e Porto Palermos, e Shkodrës, e Shurdhahut, e Vasiliqisë, e Lezhës etj.*

*Në fotografitë e përzgjedhura të Shqipërisë turistike, me site, kisha e monumente etj. kryesisht të restauruara, roli promovues e zbeh atë ndërgjegjësues, duke qenë se mungojnë shumë pasuri të trashëgimisë vendase të lëna në harresë, apo që tanimë kanë prekur degradimin. Kështu, vizitorët mund të shikojnë pamje të Kishës së Shën Kollit në Elbasan, asaj të Shën Premtes në Kavajë, Urën e Katiut në Bënjë të Përmetit etj. E megjithatë, me imazhet e Varreve monumentale të Selçës së Poshtme, ekspozita prek edhe "paraqytetërimin", me dëshmitë ilire të shekujve IV-III para Krishtit. Nuk mungojnë në këtë ngjarje modeste të artit pamor as pamjet magjepsëse të pasurive ujore vendase, që kanë kryesisht në fokus liqenet, si ai i Vaut të Dejës në Dibër, apo Liqeni i Akullnajave pranë Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë në Verilindje të vendit. Si simbol i traditës, banesave tipike vendase, por edhe i mikpritjes, ekspozita stoliset me imazhin e Shtëpisë së Çekajve (Sumaj, një nga familjet më të vjetra shkodrane). Ekspozita do të qëndrojë e çelur për publikun përgjatë dy javëve në vazhdim.*

***DORIAN KOÇI***

*Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Dorian Koçi, u shpreh se ekspozita "Promovo trashëgiminë përmes fotografisë" ka si protagonistë vetë qytetarët. Një gjetje kjo që synon të rrëzojë "muret autoritare" të institucionit e të krijojë një ambient sa më të prekshëm e familjar, veçanërisht, në një periudhë të tillë, pandemia i ka vendosur "litarin" në fyt edhe një pjese të fondeve për artin e kulturën. "Donim që të gjendej një mënyrë që të bënte të mundur kontributin e vetë qytetarëve. Pra, ata të ndiheshin pjesëmarrës dhe promovues të trashëgimisë kulturore vendase", u shpreh Koçi.*

RREZIKU NGA KORONAVIRUSI

RASTET

Në 24 orë, 127 raste të reja me COVID-19 dhe 4 humbje jete

# Java e 40-të e pandemisë, Shqipëria nuk ndryshon renditje, e fundit për testet

## *Janë kryer vetëm 28 779 teste për një milion banorë, niveli më i ulët në raport me vendet e tjera të rajonit*

ADA HAZIZOLLI

**Shqipëria vijon të mbetet e fundit në rajon për numrin e testeve të kryera në raport me popullsinë, një renditje që e ruan që prej fillimit të pandemisë.**

Duke iu referuar të dhënave të "Worldometers", rezulton që në vendin tonë janë kryer vetëm 28 779 teste për një milion banorë. Ndërkohë, në vendet e rajonit nivelet e testimit janë disa herë më të larta. Në Greqi, në total janë kryer 1,296,795 teste, thënë ndryshe 124,568 teste për një milion banorë. Në Maqedoninë e Veriut numri i testeve për një milion banorë është 89,798, në Serbi 129,194 dhe në Malin e Zi 108,675. Larg jemi edhe në raport me Kosovën ku për një milion banorë rezultojnë të jenë kryer 37 385 teste. Teksa kemi hyrë në javën e 40-të të pandemisë, pragu i testimeve luhatet në shifrat 800-870 teste në harkun e 24 orëve. Këtu përfshihen edhe testet që kryhen në strukturat private përkundrejt pagesës. Ministrja e Shëndetësisë, Manastirliu, tha të hënën se janë fuqizuar kapacitetet testuese, ndërkohë që situata mbetet ajo më sipër. Për ekspertët, gjurmimi, testimi dhe trajtimi mbeten trinomi me anë të të cilit mund të kontrollohet pandemia. Por ky rekomandim duket se ka rënë në vesh të shurdhër për sa kohë nuk është marrë në konsideratë.

**RASTET**

Të martën, referuar të dhënave zyrtare, janë kryer 820 teste në total, nga ku kanë rezultuar 127 raste të reja. "Janë kryer 820 testime dhe janë konfirmuar 127 të prekur me virusin Sars-COV 2 në këto bashki: 75 raste në Tiranë; 8 në Korçë; nga 5 raste në Fier, Gramsh; nga 4 raste në Lushnjë, Berat; nga 3 raste në Shkodër, Kavajë, Mirditë; nga 2 raste në Krujë, Elbasan, Gjirokastër, Kuçovë; nga 1 rast në Durrës, Devoll, Has, Vlorë, Pukë, Librazhd, Dibër, Roskovec, Patos. Në 24 orët e fundit, 103 qytetarë e kanë fituar betejën me COVID-19, duke e çuar numrin e të shëruarve në 7732 që nga fillimi i epidemisë", tha Mirela Cami, drejtore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

**NË SPITAL**

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, aktualisht në Spitalin Infektiv dhe "Shefqet Ndroqi" po trajtohen 190 pacientë, 16 në terapi intensive, nga të cilët 5 pacientë janë të intubuar. "Në 24 orët e fundit, me gjithë përpjekjet e mjekëve, fatkeqësisht e kanë humbur betejën me COVID-19, një 65-vjeçar nga Vlora dhe 3 qytetarë nga Tirana: një 59-vjeçar, një 75-vjeçar, një 76-vjeçar, me sëmundje bashkëshoqëruese", tha Cami. Gjithsej, janë 384 persona që kanë humbur betejën me sëmundjen që nga fillimi i pandemisë. Ministria e Shëndetësisë ka apeluar qytetarët që të përdorin maskat, duke i konsideruar ato domosdoshmëri për t'u mbajtur kudo ku ambienti është i mbyllur, në spitale, qendra shëndetësore, dyqane, supermarkete, parukeri, taksi, ambiente pune, zyra shërbimesh.

**COVID-19 – STATISTIKA**

| | |
|---|---|
| Testime totale | 87198 |
| Raste pozitive | 13518 |
| Raste të shëruara | 7732 |
| Raste aktive | 5402 |
| Humbje jete | 384 |

***Shpërndarja gjeografike e rasteve aktive sipas qarqeve:***

| | |
|---|---|
| Tiranë | 2658 |
| Durrës | 594 |
| Shkodër | 395 |
| Elbasan | 309 |
| Lezhë | 308 |
| Korçë | 255 |
| Fier | 243 |
| Vlorë | 197 |
| Kukës | 150 |
| Berat | 111 |
| Dibër | 107 |
| Gjirokastër | 75 |

**127**

**RASTE**
të reja pozitive janë konfirmuar një ditë më parë. Sipas të dhënave zyrtare, në të gjithë vendin rezultojnë 5402 të infektuar aktivë, pjesa më e madhe prej tyre në kryeqytet

**4**

**PERSONA**
kanë ndërruar jetë si pasojë e koronavirusit ditën e martë. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, janë 384 persona që kanë humbur betejën me sëmundjen që nga fillimi i pandemisë

**Dita Botërore e Zemrës, shërbimi ofrohet edhe në Spitalin "Shefqet Ndroqi".**

# "Sëmundjet e zemrës, koronarografia brenda 2 javëve"

## *Manastirliu: Urgjencat kardiake, të hapura 24 orë në 7 ditë të javës*

Mbi 8 mijë procedura në zemër janë kryer vetëm në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" gjatë këtij viti. Në Ditën Botërore të Zemrës, ministrja Manastirliu ishte në Qendrën e Hemodinamikës në QSUT, ku vuri në dukje se puna në këtë pavijon nuk është ndërprerë, pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia COVID. "Qeveria shqiptare është e angazhuar, ashtu sikurse në parandalim, edhe në trajtimin mirë të sëmundjeve kardiovaskulare, për të rritur vitet e shëndetshme, uljen e invaliditetin dhe fatalitetet nga këto sëmundje. Edhe pse në situatë epidemie, puna nuk ka ndalur jo vetëm në këtë qendër e cila performon 7-8 herë më shumë krahasuar me vitin 2014, por edhe në qendrat e hapura në spitalet e tjera. Janë rreth 35 mijë koronarografi të kryera në këto 5 vite për qytetarët, përfshirë edhe urgjencat kardiake 24/7", tha Manastirliu. Sipas saj, koha e pritjes për një koronarografi nuk i kalon 14 ditë dhe se urgjencat kardiake kryhen në çdo kohë në repartin e hemodinamikës në QSUT, ndryshe nga sa ndodhte disa vite më parë. "Sot askush nga qytetarët, nga Veriu në Jug, nuk pret dhe nuk referohet në sistemet jopublike për të kryer një koronarografi të urgjencës gjatë natës. Sot qytetarët nuk duhet të presin më shumë se 14 ditë nëse duan të bëjnë një ekzaminim nëpërmjet koronarografisë. Për këtë ka vlejtur pikërisht investimi që kemi bërë në Tiranë, në qendrën e specializuar te "Shefqet Ndroqi", në Shkodër, dhe në Spitalin Rajonal të Fierit", tha Manastirliu. Duke u ndalur te situata e epidemisë, ministrja e Shëndetësisë tha se edhe për pacientët e prekur nga COVID-19, të cilët kanë nevojë për kryerjen e një koronarografie, shërbimi ofrohet në spitalin COVID 2 "Shefqet Ndroqi". "Kemi siguruar që me vendosjen në dispozicion të spitalit "Shefqet Ndroqi" si një spital COVID 2, edhe laboratori i Hemodinamikës që është aty, është i gatshëm për të gjitha rastet e pacientëve, të cilët mund të trajtohen me COVID, por kanë nevojë për një ndërhyrje të specializuar, joinvasive në zemër", tha Manastirliu.

**SËMUNDJET**

Sëmundjet e zemrës janë ndër patologjitë më të shpeshta të diagnostikuara në sistemin shëndetësor shqiptar dhe shkaktari kryesor i vdekjeve në Shqipëri, i ndjekur nga sëmundjet cerbro-vaskulare dhe tumoret.



Ogerta Manastirliu


**NJOFTIM ANKANDI**

**Zyra e përmbarimit "Kodra Bailiff Service" sh.p.k.** në **datë 06.10.2020, në orën 16:00** (të martën), zhvillon ankandin e pare për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit **"apartament"**, me sip. 81.80 m², i ndodhur në ZK 8150, me nr. pasurie 5/224+3-44, vol. 11, fq. 178, me adresë në Tiranë, në pronësi të Hasan Hysen Meta.
Çmimi me të cilën fillon ankandi i parë është në vlerën **58,880 (peswdhjetw e tetwmijw e tetwqind e tetwdhjetw) euro.**
Ankandi do të qëndrojë i publikuar nga data 22.09.2020-06.10.2020 dhe zhvillohet në këtë datë në përfundim të orarit zyrtar (ora 16:00) në ambientet e zyrës përmbarimore "Kodra Bailiff Service" sh.p.k., me adresë në Rr. "Frederik Shiroka", Kulla.3, Shk.3 Kati 2, Nr. 4, Tiranë.
Cel +355 (0) 699381888.

**NJOFTIM ANKANDI**

**Përmbaruesi Gjyqësor Lekë Dodaj** shpall ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme të llojit **"Ndërtesë"** me numër 197/78, ZK 2460, Vol.61, Faqe 85, me sipërfaqe totale pasurie 186.90 m² e ndodhur në Linzë, Tiranë në pronësi të Palës Debitore Agron Demir Gordani.
Çmimi me të cilën do të fillojë Ankandi i Tretë është **277'200 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) Euro.**
Ankandi zhvillohet në datën **28.10.2020, ora 16:00** në zyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Lekë Dodaj, në adresën Rruga "Astrit Balluku" ,Ndërtesa 2, Hyrja 25, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
Për kontakt: Cel: 067 39 00 666 dhe me adresë email: **leke_dodaj@hotmail.com**

**NJOFTIM /ANNOUNCEMENT**

Unë i nënshkruari Abdullah Sahin deklaroj se pasaporta ime me numër serie U 03919673 lëshuar me datë 04 Janar 2012 dhe e vlefshme deri me datë 04 Janar 2022 nuk është shpallur e humbur asnjëherë nga ana ime.

I, the undersigned, Abdullah Sahin declare that my passport with serial number U 03919673 issued on 04 January 2012 and valid until 04 January 2022, has never been declared lost by me.




**NJOFTIM ANKANDI**

**Zyra Përmbarimore Private "Bailiff Services Albania" sh.p.k,** me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se në **datë 06.10.2020** do të kryejë procedurat për shitjen në ankand të III, të pasurisë të paluajtshme në pronësi të shoqërisë "Ego Ime" sh.p.k

| | |
|---|---|
| **Emri i Anijes** | **PERENA** |
| **Tipi i Anijes:** | **Peshkimi** |
| **Koha e ndërtimit** | **1940** |
| **Vendi i Ndërtimit** | **Itali** |
| **Materili i Ndërtimit** | **Druri** |
| **Çertifikata e Tonazhit** | **Nr.P-187, datë 01.10.2012,** lëshuar nga Regjistri Detar Shqiptar |
| **Përmasa sipas Regjistrit** | **Gjt. 20.35 m, Gjer. 5.32 m, Zhytja 2.50 m.** |
| **Tonazhi sipas regjistrit** | **49 Ton** |
| **Makineria Kryesore:** | **Fiat Iveko.** |

Çmimi i pasurisë në ankand të III është në vleren **3 861 093.6 lekë.**

Për informacione mund të kontaktoni në adresën e-mail: bsalbania2019@gmail.com
Cel: 0682005120, 0682005121

Në mesnatë ishte afati i fundit, si do të përzgjidhen 60 hetuesit e Byrosë

# Mbyllen aplikimet, 500 kandidatë për në BKH

## *Yuri Kim: Mos u tregoni të kënaqur e të ankoheni, veproni*



Drejtuesja e BKH, Aida Hajnaj



Ambasadorja amerikane, Yuri Kim

*Pak orë përpara se të skadojë afati i aplikimeve për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit, ambasadorja e SHBA-së në vendin tonë, Yuri Kim, ka dalë me një apel të rëndësishëm, duke u kërkuar të interesuarve që të ngrihen dhe të veprojnë. Në një postim në "Twitter", diplomatja amerikane thotë se është koha për veprim, kundër krimit dhe korrupsionit në Shqipëri. "Koha për të ndërmarrë veprime kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri. Kjo është një mundësi për të bërë një ndryshim, duke u bërë një hetues special i BKH-së. Afati i fundit i aplikimit është sonte në mesnatë. Mos u tregoni të kënaqur të uleni dhe të ankoheni – ngrihuni dhe veproni", shkruan Kim. Deri dy ditë më parë numëroheshin vetëm 165 aplikime për 60 vende si hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit. Por disa orë para se të përfundonte afati i aplikimeve, kjo shifër ka shkuar në 500, policë dhe civilë. Gara u hap më 8 shtator, ditën kur ambasadorja amerikane, Yuri Kim, zhvilloi një takim me drejtoreshën e Byrosë Kombëtare të Hetimit, Aida Hajnaj, dhe drejtuesin e SPAK-ut, Arben Kraja. Pas këtij takimi, në njoftimin e BKH-së jepeshin të gjitha detajet e kushteve që duhet të plotësojë kandidati për të qenë hetues pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe kontaktet e nevojshme. Sipas BKH-së, kandidatët duhet të kenë eksperiencë në fushat e përcaktuara në ligjin nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", si dhe në fushat që kanë lidhje me misionin e Byrosë Kombëtare të Hetimit (Ekonomik, Teknologji e Informacionit). Sipas njoftimit zyrtar të BKH-së, për të aplikuar për pozicionin e hetuesit të BKH-së kandidatët duhet të plotësojnë disa kritere, si dhe të dorëzojnë disa dokumente. Nevojitet vërtetim zyrtar që vërteton vlerësimet për aftësitë e tij /saj profesionale, etike dhe integritetin moral; vërtetim zyrtar që vërteton se ndaj tij/asaj nuk është marrë masa disiplinore e "shkarkimit nga detyra", ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit në momentin e aplikimit; një deklaratë për mungesën e konfliktit të interesit, që do të pohojë se kandidati nuk është palë ose përfaqësues ligjor në çështje që janë objekt hetimi nga BKH-ja dhe Prokuroria e Posaçme, si dhe nuk ka asnjë konflikt interesi, i cili do ta bënte të pamundur angazhimin e kandidatit në pozicionin e hetuesit. Pas kësaj do të kryhen fazat e përzgjedhjes, ku aplikantët do t'u nënshtrohen disa testimeve. Vetëm kandidatëve që do të kualifikohen për në fazën e intervistës do t'u kërkohet të dorëzojnë dokumentet në lidhje me procesin e verifikimit. Për përzgjedhjen e 60 hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit do të kryhen 5 teste përzgjedhjeje, sipas kategorive: Arsyetimi logjik, test që mat aftësitë e kandidatit në lidhje me të menduarin kritik, ku përfshihet përpunimi i fakteve, nxjerrja e përfundimeve dhe arsyetimi abstrakt; Testi i aftësisë fizike, që përfshin testim në palosje, sprint 300 m, pompa dhe vrapim 2.4 km; Shkrimi i eseve, test që mat aftësitë e kandidatit për të shprehur ide me shkrim dhe saktësinë ortografike, gramatikore, formatin, prezantimin dhe sa i është përmbajtur kandidati pyetjes; Intervista e strukturuar, test që mat aftësinë e kandidatit për të shprehur verbalisht ide, për të shprehur vlerat e tij/saj profesionale dhe për të dhënë zgjidhje për probleme që kanë lidhje me punën, si dhe testi i poligrafit; Procesi i verifikimit, kandidati për hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit duhet të kalojë në verifikimin e pasurisë dhe figurës.*

### TESTET E PERZGJEDHJES

1. Arsyetimi logjik, test që mat aftësitë e kandidatit në lidhje me të menduarin kritik, ku përfshihet përpunimi i fakteve, nxjerrja e përfundimeve dhe arsyetimi abstrakt;
2. Testi i aftësisë fizike, që përfshin testim në palosje, sprint 300 m, pompa dhe vrapim 2.4 km;
3. Shkrimi i eseve, test që mat aftësitë e kandidatit për të shprehur ide me shkrim dhe saktësinë ortografike, gramatikore, formatin, prezantimin dhe sa i është përmbajtur kandidati pyetjes;
4. Intervista e strukturuar, test që mat aftësinë e kandidatit për të shprehur verbalisht ide, për të shprehur vlerat e tij/saj profesionale dhe për të dhënë zgjidhje për probleme që kanë lidhje me punën, si dhe testi i poligrafit;
5. Procesi i verifikimit, kandidati për hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit duhet të kalojë në verifikimin e pasurisë dhe figurës.

Çela: Në 7 prokuroritë kryesore, seksione specifike për pastrimin e parave

# "Sasia e parave që vjen nga aktiviteti kriminal, shqetësuese"

## *Kryeprokurori Çela: Sukses i reformës, të ndalojë ndërhyrjet*



Prokurori i Përgjithshëm, Olsian Çela

TIRANE

**Prokurori i Përgjithshëm, Olsian Çela, thotë se është shqetësues pastrimi i parave në vend dhe evazioni.**

Sipas tij, për këtë arsye janë krijuar në 7 prokuroritë kryesore të vendit seksione specifike për krimet financiare të pastrimit të parave. Ai tha se situata që lidhet me evazionin fiskal në Shqipëri apo me sasinë e parave që vijnë nga aktivitetet kriminale është shqetësuese. Në një intervistë që Prokurori i Përgjithshëm, Olsian Çela, dha për "Euronews Albania", foli edhe për pavarësinë e Prokurorisë nga ndikime të caktuara politike, nga bota e biznesit apo nga krimi. Ndërsa ngriti si një ndër problemet më shqetësuese pastrimin e parave, pasi ka një sasi të madhe parash që vjen nga aktiviteti kriminal. "Sigurimi i elementit të pavarësisë është parë si garanci e suksesit të reformës dhe tërësia e udhëzimeve që ne kemi nxjerrë tenton të përforcojë këtë pavarësi, ta garantojë atë ndaj çdo ndërhyrjeje të jashtme apo të brendshme, pra, qoftë brenda institucionit nga ana e drejtuesve në formë hierarkike apo edhe nga ndikime të caktuara politike, nga bota e biznesit apo nga krimi", u shpreh Çela.



**PJESE NGA INTERVISTA**

I pyetur nëse ka pasur ndërhyrje, ai tha që jo, duke argumentuar se: "Sepse qasja që Prokurori i Përgjithshëm ka në raport me ligjin dhe Kushtetutën duhet të jetë e tillë, që askush të mos tentojë të ndërhyjë në punët e një organi të pavarur. Dhe këtë qasje, të cilën unë mendoj se e kam pasur, besoj ka qenë edhe një ndër arsyet kryesore pse nuk ka ndodhur ajo që ju përmendët (ndërhyrjet). Ajo që unë dua të realizoj përmes asaj çka është brenda mundësive të mia ligjore, është që kjo të mos ndodhë as në nivelet më të ulëta, as në nivelin e drejtuesve të Prokurorisë dhe as në nivelin e prokurorëve që hetojnë çështjet". Ndërsa shtoi se: "Ne duam të sigurojmë transparencë mes drejtuesve dhe prokurorëve, me qëllim që t'u mundësojmë drejtuesve të ruajnë kohezionin brenda zyrave, mënyrën sesi ato funksionojnë, por ndërkohë t'u japim mundësi prokurorëve të jenë të lirë, gjithmonë duke zbatuar ligjin dhe duke pasur përgjegjshmërinë e duhur për të arritur rezultate dhe suksese në hetime. Ajo që unë mund të bëj si Prokuror i Përgjithshëm në këtë drejtim, është të marr të gjitha masat e mundshme që mos të kemi raste të ndërhyrjes së politikës apo të elementëve të tjerë të biznesit apo elementë të tjerë të jashtëm në procesin e hetimit, në procesin e emërimit të drejtuesve të Prokurorisë, apo transferimit të prokurorëve. Në qoftë se unë do të arrij të konstatoj se do të ketë ndërhyrje të tilla, patjetër që do të marr të gjitha masat e nevojshme, aq sa më lejon ligji, për të bërë që çdo prokuror që heton, çdo prokuror linje në çdo prokurori të ndihet drejtues prokurorie, të ndihet madje edhe Prokuror i Përgjithshëm. Vetëm kështu ne mund të arrijmë t'i japim përmbajtje reformës, e cila në fakt kërkon sakrifica".

**EVAZIONI FISKAL**

Sipas Kryeprokurorit, është shumë shqetësues edhe evazioni fiskal dhe pastrimi i parave. "Sot janë krijuar në 7 prokuroritë kryesore të vendit seksionet, të cilat do të hetojnë në mënyrë specifike krimet financiare, pastrimin e parave dhe asetet kriminale. Kjo do të thotë që një pjesë e rëndësishme e luftës ndaj krimit do të bazohet në rezultatet e këtyre prokurorive. Përmes marrëveshjes që kemi arritur me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave, ne mendojmë se u kemi dhënë instrumentet e duhura prokurorive të japin rezultate në këtë drejtim. Kjo është ajo çfarë mund të bëjë Prokurori i Përgjithshëm. Unë besoj se ka mjaft punë për të bërë dhe të gjithë jemi koshientë se situata që lidhet me evazionin fiskal në Shqipëri apo me sasinë e parave që vijnë nga aktivitetet kriminale është shqetësuese. Pra, është në dorë të tyre tashmë për të dhënë rezultate. Është siguruar mbështetja e Policisë, është siguruar mbështetja e Ministrisë së Financave, e Drejtorisë së Tatimeve e Doganave dhe agjencive të tjera që të koordinojnë punën e të japin rezultate konkrete, që mund të jenë pjesë e punës më pas edhe të Prokurorisë së Posaçme", u shpreh Olsian Çela.

REFORMA NE DREJTESI

VETINGU

Brenda javës së parë të tetorit përfundon afati për ankimimin në KPA

# Vendimi për Elona Toron, karriera e Komisionerit Publik varet nga bashkëshorti i gjyqtares

## *Anëtari i KLGJ, Alban Toro relator në çështjen e komisionerit Dariel Sina, kandidon për vendin e katërt vakant në Gjykatën e Lartë*


KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

VENDIM

Faksimile e vendimit

TIRANE

**Brenda javës së parë të tetorit përfundon afati për ankimimin në KPA nga komisioneri publik i vendimit jounanim të shkallës së parë të vetingut, që konfirmonte në detyrë gjyqtaren e Apelit të Tiranës, Elona Toro.**


Gjyqtarja Elona Toro


Etleda Çiftja, anëtarja që votoi kundër

Nga praktika e deri më tanishme, vendimet jounanime të komisionit të pavarur të kualifikimit janë apeluar. Por ankimimi ose jo nga komisioneri publik i vendimit për gjytaren Elona Toro gjendet në fije të perit, pasi shkarkimi ose vazhdimi i karrierës në sistemin e drejtësisë për gjyqtaren e Apelit të Tiranës është i lidhur drejtpërdrejt me karrierën e njërit prej dy komisionerëve publikë, që kanë për detyrë apelimin e vendimit të vetingut. Komisioneri publik, Dariel Sina, kandidon për vendin e katërt vakant në Gjykatën e Lartë nga radhët e jogjyqtarëve. Ndërkohë, çështja gjendet në konflikt të pastër interesi, pasi dosja e zotit Sina në Këshillin e Lartë Gjyqësor, që administron kandidaturat, ka pasur si relator pikërisht bashkëshortin e gjyqtares Elona Toro, z. Alban Toro. Toro vërtet ia ka kaluar një tjetër anëtari të KLGJ-së dosjen e z. Sina, por një pjesë e mirë e punës tashmë është përgatitur dhe frika është se kryqëzimi i dy karrierave, mund të çojë në një vendimmarrje të padrejtë nga komisioneri publik, duke mos apeluar vendimin e dhënë nga KPK-ja për Elona Toron. Kjo e fundit kaloi në shkallën e parë të vetingut me një vendim jounanim të komisionit, por publikimi i vendimit zbuloi një sërë problemesh me pasurinë dhe anën profesionale të gjyqtares së Apelit të Tiranës.

> **Komisioneri publik, Dariel Sina, kandidon për vendin e katërt vakant në Gjykatën e Lartë nga radhët e jogjyqtarëve. Ndërkohë, çështja gjendet në konflikt të pastër interesi, pasi dosja e zotit Sina në Këshillin e Lartë Gjyqësor, që administron kandidaturat, ka pasur si relator pikërisht bashkëshortin e gjyqtares Elona Toro, z. Alban Toro**

### AFTESITE PROFESIONALE

Në konkluzion të rivlerësimit të aftësive profesionale, referuar të dhënave nga burimet arkivore dhe raportit të KLGJ-së mbi vlerësimin e aftësive profesionale, denoncimeve nga publiku, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes, unë çmoj se subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet dhe provat e paraqitura, nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për rivlerësimin e aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit ka një mënyrë pune e cila nuk pajtohet me pozicionin e saj dhe nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit mbi zvarritjet e përsëritura të gjykimit dhe të disa shkeljeve ligjore", shprehet anëtarja Etleda Çiftja.

### PASURITE

Përveç problemeve profesionale, gjyqtares së Apelit të Tiranës, Elona Toro, iu zbuluan pasuri të pajustifikuara në hetimin administrativ. Dhurime parash me hua prej mijëra eurosh të marra te miqtë që nuk justifikohen, sipas anëtares së Komisionit të Vettingut, Etleda Çiftja, pasi burimet e parave kanë qenë të pajustifikuara dhe duke bashkuar problemet profesionale, gjyqtarja Elona Toro duhet shkarkuar nga detyra. "Mangësitë profesionale të vlerësuara më lart, së bashku me deklarimin e pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, në vlerësimin tërësor plotësojnë kuadrin ligjor për të disponuar masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit duhet të ishte shkarkuar nga detyra nga shumica e trupit gjykues". Komisioni në shkallën e parë të vetingut ka qenë i ndarë për vendimin e gjyqtares së Apelit të Tiranës, Elona Toro, megjithëse shkeljet kanë qenë të shumta. Deri në javën e parë të tetorit vendimi i KPK-së duhet apeluar në shkallën e dytë të vetingut nga komisioneri publik, i cili duhet të vihet në lëvizje bazuar dhe në praktikën e deritanishme ku vendimet jounanime janë apeluar.

COSV COOPERAZIONE PER LO SVILUPPO

VACANCY ANNOUNCEMENT

Ref.No *IADSA II/2020/04*

*COSV në Shqipëri* is seeking for an experienced Project Officer to get employed in the frame of the Project: ***Revitalisation of multifunctional Center of Kolonja (Donor: IADSA II)***

**REQUIREMENTS AND QUALIFICATIONS**

- Bachelor's degree in development cooperation, business management, political science or a related field
- At least 1 year of prior experience in project management is desired
- Fluent in written and spoken both English and Albanian (Italian knowledge is desirable)
- Excellent communication and organizational skills, teamwork, flexibility
- Driver License

**DUTY STATION**: Vlorë (COSV Office), with frequent missions to Ersekë
**STARTING DATE**: November 2020
**DURATION OF CONTRACT**: 11 months (with possibilities of extension) with 3 months' probation period
**DEADLINE FOR APPLICATION**: 30/10/2020
To apply, please send your updated Europass-CV and motivation letter to the following email address: hr@cosv.org. Please specify in the object: Project Officer/Albania. Only shortlisted candidates will be contacted. For further details please visit our website https://www.cosv.org/partecipa/lavora-con-noi/

Albanian-American Development Foundation

**Request for Proposals 00149 - Feasibility Study: Increasing Institutional Capacities in Albanian Higher Education Institutions Through a Diaspora Fellowship Program**

Albanian American Development Foundation (AADF) is looking for individual local consultants/ team of consultants/organizations to conduct a feasibility study on implementation of a diaspora fellowship program that will bring highly qualified candidates from the scientific diaspora to Albanian Higher Education Institutions to carry out educational projects.

**Kërkesë për Propozime 00149 - Studim Fizibiliteti: Rritja e kapaciteteve të institucioneve të Arsimit të Lartë, nëpërmjet Programit të Bursave për Diasporën**

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) fton konsulentë lokal/ekipe konsulentësh/ kompani konsulence të zhvillojë një studim fizibiliteti mbi zbatimin e programit të bursave të diasporës, i cili do të sjellë kandidatë të kualifikuar nga diaspora shkencore në Institucionet e Arsimit të Lartë Shqiptar për të realizuar projekte në fushën e arsimit.


NJOFTIM
PËR VËND TË LIRË PUNË
HYSENBELLIU
GROUP
ARKETAR/E – LLOGARITAR/E
Hysenbelliu GROUP kërkon të punësojë një Arketar/e - Llogaritar/e , me talent dhe etikë të lartë profesionale.
DETYRAT KRYESORE:
• Kryen cdo ditë pagesat dhe arkëtimet që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë mbështetur në dokumentat justifikuese konform ligjit dhe urdhërave të administratorit.
• Kryen regjistrimet e bankës në kohë.
• Kryen regjistrimet kontabile të veprimeve të arkës dhe të bankës në programin e Financës dhe rakordon lëvizjet e brendshme midis arkës dhe bankës.
• Kryen veprimet e regjistrimit dhe kontrollit të xhiros ditore, pret faturen e Tvsh dhe kryen regjistrimet përkatëse në programin e Financës.
KERKESA TE PERGJITHSHME PER KANDIDATET:
• Të ketë mbaruar shkollën e mesme ekonomike me rezultate mbi notën 8 (kusht minimal), avantazh përbën përfundimi i studimeve në fakultetin ekonomik niveli bachelor (në një nga specialitetet Administrim –Biznes, Financë- Kontabilitet).
• Të ketë njohuri për programin FINANCA -5.
• Të ketë minimalisht 1 vit eksperiencë në ketë pozicion ose pozicione të ngjashme.
Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar Curriculum Vitae (CV) dhe një letër motivimi në adresën e e-mailit: hr@ihb-group.com.al
Vetëm kandidatët e kualifikuar mbi bazën e kërkesave të mësipërme, do të kontaktohen për intervistë


PsikologjiA
Nr. 159
MARRËDHËNIE
Dashuria
një udhëtim
i bukur
MIRËQENIE
Koha
matet me orë,
jeta
me emocione
NË FOKUS
Shkolla
duhet të fillojë
Luarasi,
universiteti i jetës
DENTAL GROUP
POLIKLINIKË DENTARE
Mariel & Stela Çeçi
POLIKLINIKA ELITARE
me shërbime evropiane!


ERJONI
NDERTIM
WE ARE HOME
Zgjidhni vendin ideal për shtëpinë tuaj!
Rr. Qemal Stafa ( Pazari i Ri )
068 40 44 970
068 20 50 264
@erjonindertimcompany
@erjoni_ndertim
info@erjoni-ndertim.com
www.erjoni-ndertim.com


green cola
Zgjidh
anën
e gjelbër
të pijeve
freskuese!
green cola
PLANTSTEVIA
0% SUGAR
HYSENBELLIU
GROUP

### Ministrja e re e Arsimit firmos urdhrin e parë për vitin akademik

# Zyrtare, universitetet hapin dyert më 2 nëntor

## *Mësim i kombinuar, vetëm laboratorët e seminaret në auditorë*

BESARTA BASHA

**Tanimë ka një datë për fillimvitin e ri akademik. Ministrja e re, Evis Kushi, ka firmosur dje urdhrin e parë që ka të bëjë me hapjen e universiteteve, në datën 2 nëntor.**



Vendimi vjen vetëm një ditë pas takimit të ministres me rektorët, ku, veç nisjes së vitit të ri, është folur edhe për modalitetet e zhvillimit të mësimit dhe detyrimet që duhen çuar përpara në kuadër të paktit të qeverisë me studentët. Deri atëherë ka përfunduar edhe procesi i pranimeve të reja me mbylljen e raundit të tretë dhe të fundit, ndërsa studentët e viteve të ndërmjetme japin provimet e fundit për t'u hedhur në vitin pasues.

**SI DO BËHET MËSIMI**

Ashtu siç është përfolur në mjediset akademike për nëntorin si muajin e mundshëm për nisjen e mësimit, ka edhe disa formate të gatshme për mënyrën sesi do të zhvillohet. Ashtu si shkollat, edhe në këtë rast, dihet vetëm data e fillimit, pasi ecuria e leksioneve e seminareve do të varet drejtpërdrejt nga shifrat e pandemisë në vendin tonë. Kujtojmë që gjatë kësaj kohe, duke qenë se universitetet kanë qenë të hapura për vitet e dyta për përmbushjen e planeve mësimore, si dhe praktikat e laboratorët, janë shfaqur raste infektimesh në Universitetin e Vlorës dhe atë të Durrësit. Një përhapje në masë, me gjasë, do të çonte në mbylljen e tyre për t'iu rikthyer mësimit online, sikundër po veprojnë klasat apo shkollat ku ka depërtuar Covid deri tani. Universiteti më i madh në vend, ai i Tiranës, e ka një skenar të gatshëm nëse ritmet e Covid-19 do të ecin me të njëjtat hapa. Rektori i ri, Artan Hoxha, ka deklaruar se leksionet online do të kombinohen me mësimin në auditorë, ndërsa po punon për hartimin e një platforme uniforme për mësimin nga shtëpia ku të aksesojnë të gjithë studentët. "Leksionet online do të kombinohen me mësimin fizik. Do mundohemi maksimalisht të përdorim auditorin dhe ta kombinojmë me mësimin online. Për këtë po përgatitemi, që të kemi një platformë të universitetit, jo më me platformë individuale. Po trajnojmë IT e fakulteteve, të jetë lehtësisht e përdorshme për pedagogët dhe studentët. Proceset që kanë të bëjnë me marrjen e dijes të studentëve, që janë seminaret, laboratorët, praktikat mësimore, ato kryesisht, duke qenë se janë në grupe më të vogla, të zhvillohen në auditorë. Kjo do të jetë zgjidhja më e mirë që të mbrohemi nga virusi, por edhe proceset mësimore të mos jenë fiktive". Ndonëse mësimi ka vijuar duke sjellë në auditorë vazhdimisht nga pak studentë, në UT nuk është raportuar asnjë student a pedagog i infektuar. Sipas Hoxhës, në rast se do të identifikohet një i tillë, do të merren masa të menjëhershme, duke nënkuptuar kështu mbyllje të një grupi a vitit akademik. Sa u takon tarifave të studimit, rektori përjashtoi rritje të tyre, teksa e bëri të qartë se as ulje nuk do të ketë, pavarësisht se studentët e kanë kërkuar. Të vetmit që do të kenë një lehtësim të vogël në masën prej 5 mijë lekësh janë studentët e masterit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 5193 Prot. Tiranë, më 29. 9. 2020

URDHËR

NR. 291, DATË 29. 9. 2020

PËR
CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË VITIT AKADEMIK 2020-2021 NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1 të nenit 87 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Viti akademik 2020 - 2021 në institucionet e arsimit të lartë fillon më datë 2 nëntor 2020.
2. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në të gjitha ndërmarrjet "Trajtimi i Studentëve" sh.a., listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Evis KUSHI

Faksimile e urdhërit të Ministrisë së Arsimit




### Raundi i dytë i regjistrimeve në universitete, 5 faza 48-orëshe

# Nisin regjistrimet e dyta, 10 mijë aplikantë në garë

## *Nga 30 shtatori-9 tetor, si të mos ngeleni jashtë listës*

Përllogariten gati dhjetë mijë maturantë që do të kërkojnë mundësinë më të mirë për t'u regjistruar në universitet në këtë dhjetëditësh. Nga sot deri më 9 tetor nis zyrtarisht raundi i dytë i regjistrimeve për shtatë mijë maturantët aplikues që nuk fituan dot në raundin e parë bashkë me maturantët e vjeshtës (pasi shlyen detyrimet e maturës shtetërore) dhe ata të viteve të kaluara që aplikuan me Formularin A3. Ndryshe nga raundi i parë, si koha, ashtu dhe mundësitë e përzgjedhjes janë më të pakta, pas ezaurimit të shumicës së kuotave kryesore në degët e shumë kërkuara. Kështu që aplikuesit duhet të kërkojnë mundësinë më të mirë me ato që iu ofrohen. Po ashtu, lëvizjet e vijës së kuqe në regjistrimet e dyta do të jenë më të ngadalta. Zgjedhja e zgjuar për dhjetë mijë të rinjtë që janë përpara një prej vendimeve më të rëndësishme në jetë është të gjejnë balancën midis meritës (pikëve që kanë) dhe preferencës (programit që duan). Ata që gjetën ID në listën e fituesve këto ditë, e kanë më të thjeshtë. Të tjerët duhet të monitorojnë çdo 48 orë lëvizjen e vizës së kuqe dhe klasifikimin në listë për raundin pasues. Shumëkush duhet ta "nuhasë" nëse dega që dëshiron është shumë larg shënjimit me të gjelbër, ashtu sikundër duhet t'i qëndrojë besnik asaj që do, duke pritur me durim në rast se ndodhet afër klasifikimit. E gjitha është luftë me kohën. Nga shtatë faza, ky raund vjen me pesë të tilla, në varësi të të cilave duhet të përllogarisë edhe kohën që i duhet për t'u shpallur fitues. Sidoqoftë, për ata që nxitohen, ka një zgjidhje. Një afat dyditor çregjistrimesh është parashikuar pas datës 9, për të riaplikuar në raundin e tretë dhe të fundit. Por duhet pasur kujdes. Për çdo raund që kalon, kuotat e lira janë gjithnjë e më të limituara. Para se të bëjnë çregjistrimin në një degë me mendimin që do fitonin diçka tjetër më të mirë, të rinjtë duhet të sigurohen që ka vende bosh në atë ku duan të shkojnë. Muaji tetor përkon me raundin e fundit që presupozohet të mbushë kuotat bosh në universitete. Në këtë vit, ndryshe nga ata që shkuan, IAL-të kanë mundësi të bëjnë rialokim kuotash, duke kaluar ato që nuk mbushen një tjetër programi ku ka interes nga ana e të rinjve. I gjithë procesi parashikohet të mbyllet më 31 tetor (sipas kalendarit të datave bashkëngjitur shkrimit), për të rinisur dy ditë më vonë vitin e ri akademik.




### KALENDARI I REGJISTRIMEVE

**RAUNDIT II**
29 shtator – ankimimi
30 shtator-9 tetor – regjistrimi në universitete përmes 5 fazave 48-orëshe (kohëzgjatja dhjetë ditë)
10-11 tetor – çregjistrimi i fituesve pas ankimimit

**RAUNDI III**
30 shtator -11 tetor - pagesa e tarifave
12-14 tetor – aplikimi online, përzgjedhja e dhjetë degëve
19 tetor - publikohet renditja e aplikantëve në portalin u-albania
20 tetor – ankimimi
21-26 tetor – regjistrimi në universitete përmes 3 fazave 48-orëshe (kohëzgjatja gjashtë ditë)
27-31 tetor – regjistrimi në sekretarinë mësimore të njësive kryesore (fakultetet), pesë ditë kohëzgjatje

**15**

**MIJE**
maturantë nga afro 22 mijë aplikues për këtë vit e kanë gjetur veten duke u regjistruar në degën e fituar. Në dy raundet e mbetura vijojnë garën shtatë mijë të tjerët bashkë me maturantët e vjeshtës dhe ata të viteve të kaluara që aplikuan së fundmi

Bashkë me Tahirin, rekurs të vendimit bëri edhe i pandehuri Jaeld Çela

# Tahiri në Gjykatë të Lartë, kërkon pushimin e çështjes

## *Rekursi, pas vendimit të Apelit për rishqyrtimin e dosjes*

TIRANE

**Gjykata e Lartë ka regjistruar rekursin e bërë nga ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, dhe ish-drejtori i Policisë Vlorë, Jaeld Çela.**

Ish-ministri Tahiri kundërshton vendimin e Apelit të Posaçëm që u dha më 26 qershor, që e ktheu dosjen në ngarkim të tij për rigjykim në Shkallën e Parë. Vendimit në fjalë i është bërë rekurs edhe nga ish-drejtuesi i Policisë së Vlorës, Jaeld Çela. Ata i kërkojnë Gjykatës së Lartë të prishë vendimin e Apelit dhe të pushojë çështjen në ngarkim të tyre. Në rast se pranohet, çështja do të kalojë për seancë gjyqësore, por duhet theksuar që Gjykata e Lartë është akoma në kolaps për shkak se nuk është e formuar me gjyqtarë. Përballja e Tahirit me drejtësinë nisi në nëntor 2017, kur ai u dyshua se i garantonte siguri grupit të "Habilajve" në trafikun e drogës.


Saimir Tahiri

### ÇFARË VENDOSI APELI NDAJ TAHIRIT

Gjykata e Posaçme e Apelit shprehet në vendim se nuk mund të japë një vendim dënimi ndaj ish-ministrit të Brendshëm, ndërkohë që nuk ishte bërë asnjë hetim për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës", për të cilën Shkalla e Parë e dënoi atë. "Ky kolegj vlerësoi të pabazuar shkakun e pretenduar nga Saimir Tahiri dhe mbrojtësi i tij. Ky Kolegj çmoi se vendimi i marrë nga gjyqtari i hetimeve paraprake të Katanias në Itali nuk i plotëson kushtet për t'u cilësuar përfundimtar në respektim të nenit 34 të Kushtetutës së Shqipërisë. Së dyti, ky Kolegj, duke shqyrtuar në themel faktet e atribuuara të të pandehurve Saimir Tahiri dhe Jaeld Çela në raport me aktin e njoftimit të akuzës dhe kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq të Prokurorisë, në raport me vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake, si dhe në raport me konkluzionet e arritura nga vendimi i apeluar, vlerësoj se në rastin konkret janë shkelur dispozitat për paraqitjen e akuzave të reja, e lidhur kjo edhe me mosrespektimin e dispozitave për ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori. Gjykata ka zbatuar gabim nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale, se në këtë rast Gjykata nuk ka rivlerësuar të njëjtin fakt që i atribuohet nga Prokuroria të pandehurit, por de facto ka ngritur një akuzë të re, për të cilën Saimir Tahiri dhe Jaeld Çela as nuk janë hetuar dhe për më tepër, nuk u është atribuuar kultivimi i narkotikëve apo dhe përhapja e kultivimit në Shqipëri. E lidhur kjo me episode konkrete të sekuestrimit dhe asgjësimit të narkotikëve në datat 13.09.2016, 04.10.2016 dhe 18.10.2017. Në lidhje me këto episode dhe kultivimin e narkotikëve, prokurorët janë shprehur se nuk kanë ngritur akuzë ndaj të pandehurve Saimir Tahiri dhe Jaeld Çela, por janë referuar duke mbështetur ekzistencën dhe qëndrueshmërinë e grupit të strukturuar kriminal, pjesë e të cilit akuzohet se janë edhe dy të pandehurit. Gjykata e Krimeve të Rënda, ndonëse e vlerësoi si kontradiktor këtë qëndrim të Prokurorisë, në vijim, duke iu referuar episodeve që lidhen me sekuestrimin dhe asgjësimin e bimëve narkotike në 2016-'17, rikualifikon faktin penal atribuuar të pandehurve në lidhje me trafikimin e narkotikëve në 4 episode konkrete dhe cilësuar si shpërdorim detyre", thuhet në vendimin e dhënë nga Gjykata e Posaçme e Apelit.

Trafiku i 613 kg kokainë


Arbër Çekaj

# U dënua me 21 vite burg, Arbër Çekaj apelon vendimin e Gjykatës

Kjo rrëzon gjithçka. Nëse, bie fjala, vetë Kryeministri kandidon në një zonë me 10 mandate, natyrisht që ai do të fitojë pjesën dërrmuese të votave të partisë së tij. Nëse ai merr 80 për qind të votave të partisë së tij, mbetet që 9 të tjerët të marrin 20 përqindëshin e mbetur, ku vështirë se dikush mund ta kalojë pragun e vendosur.

Hapja e listave ishte vetëm një pretekst për të prishur marrëveshjen e 5 qershorit. Qeveria luajti keq në tryezën politike, duke menduar se po ia linte "topin në dorë opozitës", të cilën e mendoi të kompleksuar nga vetë ulja në tryezë. Por nuk rezultoi kështu. Opozita pranoi kushtet e marrëveshjes dhe gjithçka u mbyll me një dakordësi, çfarë u konsiderua sukses edhe nga ndërkombëtarët. Në këto kushte, Ramës i duhej një alibi për ta prishur këtë marrëveshje dhe për këtë gjeti listat. Me pretendimin se ato i kërkon populli, ai doli me qëndrimin se vullneti i qytetarëve është përmbi çdo marrëveshje, e madje edhe mbi kushtet e BE-së.

Propozimi i opozitës, i cili shkon edhe më larg duke kërkuar lista 100 për qind të hapura, e rrëzoi plotësisht këtë alibi. I kapur në cep, ai po përpiqet të shtyjë përpara vendimin për të prishur koalicionet dhe po debatin mbi listat po e përdor vetëm si zhurmë mediatike, për të kaluar gjithçka me sa më pak kosto, ndërsa reagimet e ndërkombëtarëve vijnë duke u shtuar.

Ideja se Rama po e bën gjithçka për populizëm nuk qëndron më, për sa kohë ofron modele ku listat nuk janë të hapura. Populizmi i duhej si një truk për të fshehur një të keqe edhe më të madhe, por kjo nuk funksionon më. Të vetmet mekanizma që i kanë mbetur janë dhuna dhe prishja e rregullave të lojës, të cilat tashmë po i luan haptas. Deklaratat ultimative ku ai u kërkon vartësve 74 mandate, - gjejini ku të doni dhe si të doni - është një mesazh i qartë kërcënues i bërë haptas, në sytë e të gjithëve.

Gjithçka është në fushën e perceptimeve. Propaganda qeveritare tashmë po përpiqet të krijojë perceptimin se do ta mbajë pushtetin me çdo mjet, duke tentuar të demotivojë me këtë të gjitha flukset e faktorëve të rreshtuar kundër tij. Krijimi i bindjes se, sido që të jetë, ai do të fitojë, është i vetmi mekanizëm për të mbajtur shtrënguar aparatin e kontrollit mbi zgjedhjet, i cili po i shket duarsh. Sidoqoftë, të gjitha këto janë shenja se ky pushtet po konsumon edhe gurët e fundit. Kostoja politike e marrë përsipër me prishjen e marrëveshjes tregon se kjo qeveri ka hyrë tashmë në një rrugë pa krye, nga e cila nuk e di as vetë se si do dalë.

# "Skandalet e Trumpit nuk janë më ndonjë gjë e madhe"

INES POHL



Në kohë normale, një President amerikan edhe mund të rrëzohej nga zbulime të tilla si truket tatimore. Por Donald Trump me truket e tatimeve ka gjasë madje që të përfitojë, thonë ekspertët, para debatit të parë televiziv.

Uashingtoni politik për pak minuta mbajti frymën të dielën në mbrëmje: Në një raportim ekskluziv, gazeta "New York Times" publikoi hapur se Presidenti Donald Trump në 10 nga 15 vitet e fundit nuk ka paguar tatime në nivel federal, në vitin 2016 si edhe në vitin e parë si President, madje 750 dollarë. Nga raportimi mund të mendosh se Donald Trump ose ka qenë mjaft i paskrupullt në mënjanimin e tatimeve, ose një biznesmen shumë i keq - ose, gjë që është më e mundur, ai i ka të dyja. Për ta kuptuar më mirë: Qytetari amerikan mesatarisht paguan 12.200 dollarë tatime, 16 herë më shumë se Trump. Presidenti vetë menjëherë i damkosi këto informacione si gënjeshtra që i përhap shtypi liberal për ta dëmtuar atë.

**PAK PARA DUELIT TELEVIZIV**

Nuk është rastësi që gazeta liberale "New York Times", që prej muajsh lufton me të gjitha mjetet publicistike kundër rizgjedhjes së Trumpit, këtë lajm bombë e lëshon pak para duelit të parë televiziv, me shpresën e dukshme që këto informacione të ndihmojnë sfiduesin demokrat, Joe Biden, në debatin televiziv të martën (29.09). Ky është dueli i parë nga tri duele televizive dhe merr një rëndësi të veçantë në këtë vit të koronës, kur kandidatët dhe ekipi i tyre organizojnë shumë pak mitingje zgjedhore publike dhe ku pritet që miliona vetë t'i ndjekin përmes televizionit.

Çdo 15 minuta do të trajtohet një kompleks temash: Gjykata Supreme, pra më konkretisht do të flitet për pasuesen e gjyqtares së ndjerë Ruth Bader Ginsburg, situata e COVID-19, ekonomia, racizmi dhe dhuna në qytete, bilanci politik i Trumpit dhe Biden-it, si dhe integriteti i zgjedhjeve në vetvete. Shërbimet Sekrete amerikane i tremben ndikimit nga jashtë si në vitin 2016. Trump prej javësh pretendon se votimi me postë është i pasigurt dhe i manipulueshëm dhe hap rrugën kështu për të kontestuar votimin në rast moszgjedhjeje. Gjatë transmetimit nuk është parashikuar një verifikim faktesh.

"Ndoshta kjo histori nuk ka për të ndryshuar ndonjë gjë në sjelljen në votime të përkrahësve të Trumpit", thotë Sheri Berman, politologe në "Bernard College" në Universitetin e Columbias. Në peizazhin mediatik mjaft të polarizuar ka shumë pak vetë që i ndjekin zhvillimet. Përveç kësaj, në vitet e kaluara njerëzit janë mësuar me gënjeshtrat e shumta dhe skandalet. "Kjo nuk është më ndonjë gjë e madhe këtu në Shtetet e Bashkuara", thotë Berman.

**NJË PROVË PËR ZGJUARSINË E TRUMPIT**

Po kaq nuk mjafton: Politologia e konsideron të mundur që Trump përmes mënjanimit të tatimeve, madje te disa përkrahës të tij, të fitojë pikë sepse veprimin e tij ata e shohin provë se sa i zgjuar është Presidenti dhe sa mirë di që me truke të caktuara të nxjerrë përfitimin më të madh për vete. Por çfarë mundësish ka atëherë Joe Biden të fitojë pikë në këtë duel të parë televiziv kaq të rëndësishëm e që do të ndiqet me vëmendje brenda e jashtë SHBA-së.

Për të pasur vërtet ndikim te votuesit e pavendosur, Biden duhet të përqendrohet te cilësitë e tij më pozitive e të argumentojë pse është kandidati më i përshtatshëm për t'u përballuar me situatën ekonomike të vështirë në vend. Ai duhet të synojë të përmendë edhe sjelljen në qeveri të personelit mjaft të kualifikuar, një qeveri që do të jetë e aftë nga dita e parë, thotë eksperta Berman. "Ne pamë në vitin 2016 te Hillary Clinton se fokusimi tek elementi negativ i kundërshtarit nuk mjafton".

Raportimi për truke tatimore të Trumpit te shumica shkakton tanimë vetëm një ngritje supesh, është e bindur Berman. "Të gjithë e dinë ndërkohë, se çfarë njeriu është Donald Trump. Ata e votojnë atë për politikën e tij, ose sepse thjesht nuk i duan demokratët". **D.W.**

STRATI

NJOFTIM ANKANDI

Zyra e Përmbarimit privat **"STRATI" Sh.p.k.,** njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme, rregjistruar në emër të Veli Pelivan Meçaj të llojit:
- **truall** me sipërfaqe 270 $m^2$, nga e cila 125 $m^2$ ndërtesë, Nr. 8/457, volumi 17, faqe 55, ZK 8220, ndodhur në Tiranë. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **73,360 Euro.**
- **apartament** me sipërfaqe 75 $m^2$, Nr. 7/182+4-49, volumi 4, faqe 239, ZK 8220, ndodhur në Tiranë, Rruga "Kongresi i Lushnjës". Çmimi me të cilin fillon ankandi është **32,340 Euro.**
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 07.10.2020 në ora 16.00, në ambjentet e Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati " shpk, Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

NJOFTIM ANKANDI

**Zyra e Përmbarimit Privat "T.M.A" SHPK** shpall për shitje në ankand të III-të pasuritë e ndodhura në Tiranë, të rregjistruar në ZVRPP Tiranë, në pronësi të hipotekuesit shoqëria "ZAIMAJ" shpk të llojit:
- **Godinë banimi dhe shërbimi** 1-5-7 kate dhe një kat përdhe, me Sip.167.7 $m^2$, Njësi në katin përdhë, Njësia Nr.7, me vendndodhje në Linzë Tiranë, ZK 2460, rregjistruar në rregjistrin hipotekor nr.68, datë 02.02.2008, në vlerën **12,678,120 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e njëzet) Lekë**.
- **Godinë banimi dhe shërbimi** 1-5-7 kate, kati përdhe, me Sip. 114 $m^2$, Njësia Nr.8, me vendodhje në Linzë Tiranë, ZK 2460, rregjistruar në rregjistrin hipotekor nr.69, datë 02.02.2008, në vlerën **8,618,400 (tetë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetëmijë e katërqind) Lekë**
Ankandi për shitjen e pasurive të mësipërme do të zhvillohet me **datë 09.10.2020 ora 16:00**, në Qendrën e Zhvillimit të Ankandeve Publike (QZHAPP), pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësore Private në adresën: Rruga "Nikolla Jorga", Ndërtesa 9, Kati 2, Tiranë. Për informim më të detajuar kontaktoni: Tel-Fax +355 42 227 388 e-mail: tmapermbarimi@yahoo.com

TABAKU-2010

NJOFTIM ANKANDI

***Shoqeria Permbarimore "TABAKU-2010" sh.p.k***
***Njofton shpalljen e ankandit :***
-Më date.05.10.2020 ora.16:00(te Hene)zhvillohet ankandi I pare,per shitjen e pasurise te sekuestruar,per llogari te kreditorit,Devis Mema,me te dhenat si me poshte:
***-Truall me sip 700 $m^2$,*** me adrese,Lagj.10 Rr "Spiro Kozma" prane unazes se qytetit Korce,ankandi i pare fillon me cmimin ne shumen prej ***1,960.000 leke,*** ne pronesi te hipotekuesit,Klea Spiro.
-Më date.22.05.2017 ora.16:00(te Hene)zhvillohet ankandi i trete,per shitjen e pasurise te sekuestruar,per llogari te
Ankandi zhvillohet prane Zyres Permbarimore Shoqeria "TABAKU-2010"Sh.p.k,me adrese Lagj.7 Rr "Floresha Myteveli" Pallati Perballe Bashkise Kati 2te Korce,Cel.0684013602 ose adresen e-mail: petrit_tabaku@yahoo.com.

NJOFTIM ANKANDI

**Përmbaruesja Gjyqësore Ermira Mhilli** me adresë Lgj."Qemal Stafa", Rr."Don Bosko", përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, njofton se në **datë 28.10.2020, ora 16:00** në ambientet e saj do të zhvillohet ankandi i dytë për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit: **Truall + Ndërtesë**, me vërtetim dokumenti hipotekor nr.347, datë 28.10.2011, me nr.30 regjistri hipotekor datë 28.02.2003, me sipërfaqe 108.4 $m^2$, Z. Kadastrale 8593, me adresë Lgj. "Perlat Rexhepi", Shkodër, në vlerën **4.648.000 (katër milion e gjashtëqind e dyzet e tetë mijë) lekë.**
Ofertuesit të drejtohen pranë Zyrës së Përmbarueses Gjyqësore Ermira Mhilli, ose të kontaktojnë nëpërmjet Nr.tel 0692219253 ose adresës së emalit: ermira.mhilli@hotmail.com.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

# DEKRET

## "PËR RISHPALLJEN E THIRRJES PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE "VAKANCË E PARAKOHSHME""

Në mbështetje të neneve 93, 125, 127 pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, neneve 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh pika 2, 86 pika 4 shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pasi vlerësova njoftimin **nr. 268 prot., datë 18.09.2020** dhe **Vendimin nr. 29, datë 16.09.2020**, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, administruar me nr. 3188 prot., datë 21.09.2020, nëpërmjet të cilit KED-ja ka vendosur njoftimin e Presidentit të Republikës për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme e shpallur fillimisht nga Presidenti i Republikës me **Dekretin nr. 10723, datë 07.02.2018**, rishpallur me **Dekretin nr. 11291, datë 27.09.2019**, për shkak se në përfundim të procedurave të verifikimit të ndjekura nga KED-ja, rezulton se në garë për plotësimin e këtij vendi vakant aktualisht nuk ka kandidatë të kualifikuar me vendim të formës së prerë,

***D e k r e t o j:***

**Neni 1**

Rishpalljen e procedurës së aplikimit për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë me qëllim plotësimin e "Vakancës së parakohshme" të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit të ish-gjyqtarit Besnik Imeraj.

**Neni 2**

Rishpallja e kësaj procedure aplikimi dhe publikimi i saj sipas tekstit bashkëlidhur të bëhet menjëherë në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës.

**Neni 3**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.
**Nr. Dekretit 11742**

**Tiranë, më 24.09.2020**

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**
**ILIR META**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

# NJOFTIM

## PËR RISHPALLJEN (*PËR TË TRETËN HERË*) TË PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE "VAKANCË E PARAKOHSHME"

Presidenti i Republikës, pasi u njoh me njoftimin nr. 268 prot., datë 18.09.2020 dhe Vendimin nr. 29, datë 16.09.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, administruar me nr. 3188 prot., datë 21.09.2020, **konstatoi se:**
Në përfundim të procedurave të verifikimit të kandidaturave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese "Vakancë e parakohshme", e krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit të ish-gjyqtarit Besnik Imeraj, e shpallur fillimisht për aplikim nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr.10723, datë 07.02.2018 dhe rishpallur me Dekretin nr. 11291, datë 27.09.2019, rezulton se në garë për plotësimin e këtij vendi vakant nuk ka kandidatë të kualifikuar me vendim të formës së prerë.
Me përfundimin përpara kohe të mandatit të ish-gjyqtarit Besnik Imeraj, Presidenti i Republikës me **Dekretin nr. 10723, datë 07.02.2018** shpalli procedurën për plotësimin e kësaj vakance.
Nga **15 (pesëmbëdhjetë) kandidatë** që shprehën interesin për konkurrim, në përfundim të procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi dhe lejoi kandidimin vetëm për **2 kandidatë**, konkretisht:

1. Zoti Besnik Muçi.
2. Zonja Regleta Panajoti.

Presidenti i Republikës, pasi vlerësoi informacionin dhe njoftimin e përcjellë me shkresën nr. 530 prot. datë 26.09.2019 nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me **Dekretin nr. 11291, datë 27.09.2019,** dekretoi: "*Rishpalljen e procedurës së aplikimit për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e "Vakancës së parakohshme", të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit të ish-gjyqtarit, zotit Besnik Imeraj.*"
Pas përfundimit të afatit të rishpalljes për aplikim për këtë vend vakant, rezultoi se shprehën interesin për kandidim edhe **6 aplikantë të tjerë,** përveç **2 (dy) kandidatëve** që vijonin të ishin në garë në atë moment për plotësimin e "Vakancës së parakohshme" në Gjykatën Kushtetuese.
Lista e kandidatëve iu dërgua menjëherë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me shkresën me nr. 3802 prot., **datë 22.10.2019.**
Në përfundim të procedurës së vlerësimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidatëve për këtë vend vakant nuk është lejuar kandidimi për **asnjë nga 8 kandidatët,** që shprehën interes dhe paraqitën kandidaturën, ndërsa për kandidatin e fundit të ngelur në garë të verifikuar nga KED, **zotin Shaqir Hasanaj, vendimi i KED-së për ndalimin nga kandidimi është kundërshtuar në Gjykatën e Apelit Administrativ dhe nuk ka ende një vendim gjyqësor të formës së prerë**.
Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e datës 16.09.2019 shqyrtoi gjendjen e krijuar për këtë vend vakant dhe me vendimin nr. 29, datë 16.09.2020, vendosi të njoftojë Presidentin e Republikës për të vlerësuar mundësinë e rishpalljes së procedurës së konkurrimit për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të krijuar për shkak të përfundimit përpara afatit të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj. Ky njoftim është administruar në Institucionin e Presidentit të Republikës me nr. 3188 prot., datë 21.09.2020.
Bazuar në këto kushte, ku në garën për kandidim për plotësimin e kësaj vakance nuk ka kandidatë të kualifikuar me vendim të formës së prerë (ndërsa vetëm për kandidatin Shaqir Hasanaj vijon procesi gjyqësor), çka në çdo rast bën që të mos plotësohet numri i domosdoshëm prej 3 (tre) kandidatësh, i parashikuar nga **neni 125, pika 1** e Kushtetutës dhe **neni 7/b, pika 4** e ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, neneve 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh pika 2, 86 pika 4 shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pasi u njoh dhe vlerësoi njoftimin nr. 268 prot., datë 18.09.2020 dhe Vendimin nr. 29, datë 16.09.2020, të KED-së, me qëllim ndjekjen pa vonesë të procedurave të kërkuara nga Kushtetuta dhe ligji për plotësimin e kësaj **"Vakance të parakoshme"** në Gjykatën Kushtetuese, në cilësinë e organit të emërtesës, me **Dekretin nr. 11742, datë 24.09.2020**, ka miratuar:
• Rishpalljen e procedurës së aplikimit për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë me qëllim plotësimin e **"Vakancës së parakohshme"**, të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit të ish-gjyqtarit **Besnik Imeraj**.
**Presidenti i Republikës, duke vlerësuar informacionin e përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe ecurinë e procesit për plotësimin e këtij vendi vakant, dhe ripërtëritjen sa më parë të Gjykatës Kushtetuese, fton dhe inkurajon:**
Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi të hapur publik për plotësimin e vendit vakant, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës këto dokumente:

- Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të rishpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (*numër telefoni/e-mail);*
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqërues, nëpërmjet të cilit vërteton përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 125, pikat 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit është i publikuar bashkëlidhur këtij njoftimi në faqen e Institucionit të Presidentit të Republikës.
- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular i cili gjendet i publikuar bashkëlidhur këtij njoftimi në faqen e Institucionit të Presidentit të Republikës.

**Afati i paraqitjes së kërkesës për shprehjen e interesit, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm bashkëlidhur është data 14 tetor 2020.**
Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikuesve do të publikohet në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës si dhe në mjetet e informimit publik.
Lista e aplikuesve dhe dosjet respektive të tyre do t'i përcillen **menjëherë** Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vijimin e procedurës së verifikimit dhe vlerësimit sipas Kushtetutës dhe ligjit.
Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente ecurinë dhe çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
Për lehtësinë e të gjithë aplikuesve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjeni të botuar përmbajtjen e nenit 125, pikat 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për verifikim dhe vlerësim për emërimin si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.
**• Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

**Neni 125**

*[…] 4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.*
*5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj. […]*
**• Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar:**

Neni 7/a

**Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese**
***1**. Gjyqtari i Gjykatës Kushtuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar **që përmbush këto kushte:***
*a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
*b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
*c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
*ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
*d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
*dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*
***2**. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, **duhet të plotësojë edhe këto kritere:***
*a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;*
*b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;*
*c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.*
***3**. Plotësimi i kritereve të mësipërme **vlerësohet në bazë të:***
*a) vjetërsisë në profesion;*
*b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;*
*c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;*
*ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;*
*d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;*
*dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.*
***4**. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.*
Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejt në zyrën e protokollit të Institucionit të Presidencës, në adresën: *Institucioni i Presidentit të Republikës, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.*
**Sqarim:**

1. Njëri prej kandidatëve në garë për plotësimin e kësaj vakance, zoti Shaqir Hasanaj, nuk ka ende një vendim të Gjykatës së Apelit Administrativ për shqyrtimin e vlefshmërisë së vendimit të KED-së për ndalimin nga kandidimi.
2. Në zbatim të nenit 127, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 7/dh, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për oganizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, kandidati që do të propozohet nga KED dhe do të përzgjidhet nga Presidenti i Republikës për t'u emëruar gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, për plotësimin e vakancës së parakohshme të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit ish-gjyqtarit Besnik Imeraj, do të qëndrojë në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.

**Tiranë, më 24.09.2020**

**Formular Vetëdeklarimi**
**Formular – AIDSSH**


ALBtelecom ...me ju të parët!

**NJOFTIM I KOMPANISË ALBTELECOM SH. A.**

ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e telefonisë së lëvizshme se duke filluar nga data 7 tetor 2020, do të ofrojë 5 paketa të reja me parapagesë, me detajet si më poshtë:

| Paketat me Parapagesë | Super 400 Pa Limit | Super 700 Pa Limit | Super 1100 Pa Limit | Super 1300 Pa Limit | Super 1900 Pa Limit |
|---|---|---|---|---|---|
| Çmimi (me TVSH) | 400 Lekë | 700 Lekë | 1100 Lekë | 1300 Lekë | 1900 Lekë |
| Minuta Kombëtare | 200 | 500 | 3000 | 2000 | Pa limit |
| Minuta drejt ALBtelecom Fiks | 200 | 800 | Pa limit | Pa limit | Pa limit |
| Minuta Ndërkombëtare | | | | | 150 |
| SMS brenda rrjetit | | | 1000 | | Pa limit |
| SMS Kombëtare | 100 | 500 | 500 | 1500 | 1500 |
| SMS Ndërkombëtare | | | | | |
| Internet | Pa limit pas 100 MB | Pa limit pas 1 GB | Pa limit pas 4 GB | Pa limit pas 12 GB | Pa limit pas 18 GB |
| Internet Dhuratë* | 100 MB | 1 GB | 4 GB | 12 GB | 18 GB |
| Vlefshmëria | 30 Ditë | 30 Ditë | 30 Ditë | 30 Ditë | 30 Ditë |

*Vëllimi i Internetit **Dhuratë** do të jepet për një periudhë promocionale që nga hedhja në treg e paketave të reja.*

*Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare **www.albtelecom.al** ose telefononi Shërbimin e Klientit në **123.***



RisiAlbania Partner for Growth

A project of the Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

## Call for Proposal: Sector Selection, Delimitation and Sectorial Skills Analysis to establish Sectorial Skills Committees

RisiAlbania is a youth employment project of the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) and implemented by a consortium consisting of HELVETAS Swiss Intercooperation and Partners Albania.

Under the component of skills development, RisiAlbania is supporting the National Agency for Vocational Education, Training and Qualifications (NAVETQ) in the process of establishing the tools and modalities for the operationalization and functioning of the SSCs and piloting of the first SSC in one of the economic sectors.

In this view, RisiAlbania is looking to engage a Consultant (Contractor) to provide services to developing the methodologies of 1) sector selection, 2) sector delimitation and 3) conducting SSA in close cooperation with NAVETQ. The Contractor will be required to also pilot the methodologies and provide the first results in selection of up to five priority sectors. Then, one sector will be defined for piloting and the consultant will work for the sector delimitation and conduct the SSA for this sector.

Applicants are expected to submit (i) a detailed technical proposal outlining the methodologies, activities and timeline to complete this assignment, (ii) reasons why you are the best candidate, (iii) organization profile/CVs of the proposed team, (iv) financial proposal disaggregated according to working days of each expert involved.

Deadline for submission via hard copy and soft (USB stick), in closed and stamped envelope, is 12 October 2020, 12:00 (noon) at RisiAlbania (Rr. Ismail Qemali, P.18, H.3, Ap.15, Tirana, Albania).

Download here the full Call for Proposals: https://drive.google.com/file/d/1FtZtz6-f331MYOE-_K6kilyhYP0Tgt3Z/view?usp=sharing

In partnership with: Implemented by:

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

HELVETAS ALBANIA

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

## Shqiptarët në Mal të Zi lejohen të përdorin simbolet kombëtare

Qeveria e Malit të ZI ka miratuar përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar për komunitetin shqiptar, pas propozimit nga Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve në Mal të Zi. Po ashtu, qeveria malazeze ka miratuar edhe përdorimin e himnit kombëtar të Shqipërisë, si dhe festimin e 28 nëntorit si festë kombëtare për shqiptarët në vendin fqinj. Përdorimi i simboleve kombëtare nga pakicat në Mal të Zi paraqiste një problem të vazhdueshëm dhe ishte objekt debatesh midis forcave politike shqiptare dhe zyrtarëve malazezë. Sipas "VOA", pas mosmarrëveshjeve të shumta, qeveria e Malit të Zi në nëntor të vitit të kaluar miratoi projektligjin për simbolet kombëtare të propozuar nga Ministria për të Drejtat e Njeriut. Shfaqja e simboleve kombëtare në Mal të Zi është pasojë e ligjit për ruajtjen e qetësisë publike, i cili ishte në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën dhe parashihte dënime në rast se shpalosen simbolet e shteteve të tjera. Në bazë të ligjit të Malit të Zi për rendin publik, një qytetar që tregonte publikisht një flamur, stemë ose simbol të një shteti tjetër pa autorizim, gjobitej me 100 deri 500 euro, ose dënohej me burgim deri në 30 ditë. "VOA" kujtoi se gjykatat në Mal të Zi kanë ndëshkuar shumë shqiptarë në Tuz apo Ulqin për shkak të përdorimit të flamurit shqiptar.



### Sekretari Amerikan takon Kryeministrin grek, vizitojnë bazën në Kretë

# Konflikti në Mesdhe, SHBA çon "Mamuthin" në krah të Greqisë

### *Kërkimet për gaz e naftë, Pompeo: Mbështesim dialogun Greqi-Turqi*

**Shtetet e Bashkuara kanë vendosur të dërgojnë "Mamuthin" në krah të Greqisë në Mesdhe, aty ku po "vlon" rreziku i një përplasjeje me Turqinë për shfrytëzimin e burimeve të gazit në tokën nënujore.**

Sekretari Amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha të martën se Shtetet e Bashkuara do të bazojnë një anije gjigante të Marinës në një bazë ushtarake të përbashkët me Greqinë, vetëm 600 milje nga bregdeti turk. "Hershel 'Woody' Williams", një anije ekspedite e bazës detare dhe nuk është lloji i anijes që mund të ndërhyjë në një konflikt me intensitet të lartë, nëse tensionet në rritje midis Turqisë dhe Greqisë, të dy vende aleate të NATO-s, arrijnë në një përshkallëzim të padëshiruar. Por vendosja e saj në "Souda Bay", një bazë e përbashkët mes SHBA-së e Greqisë, afër vendit ku Turqia në fillim të këtij viti dërgoi anije studimi dhe shpimi për të kërkuar gaz, mund të shërbejë si një paralajmërim simbolik i SHBA-së mbi acarimin në rritje në rajon, sipas "New York Times". Çështja e mosmarrëveshjeve me Turqinë dhe mënyra për të zgjidhur konfliktin për të mos lejuar përshkallëzimin në një konfrontim ushtarak ishte tema qendrore e takimit të Kryeministrit Kyriakos Mitsotakis të Greqisë me Sekretarin Amerikan Mike Pompeo, pas një serie turnesh në "Souda Bay" të martën. Mitsotakis akuzoi Turqinë për shkeljen e ligjeve ndërkombëtare me strategjinë e saj ekspansioniste për të kërkuar burime energjetike në Mesdheun Lindor dhe Egje, zona që sipas tij, kontrollohen nga Greqia dhe vendet e tjera. "Është një zonë shumë e ndjeshme që është testuar kohët e fundit nga agresiviteti i Turqisë me veprime provokuese", u tha Mitsotakis gazetarëve pas një takimi privat me Pompeon. Ai shtoi se Turqia kishte nxitur tensionet me retorikë ekstreme dhe informacione të pavërteta për qëllimet e saj. "Me fjalë të tjera, veprime që janë në kundërshtim me vlerat e botës perëndimore", tha Mitsotakis. Situata e krijuar në Mesdhe nuk është shumë e favorshme as për SHBA-në. Me gjithë interesat që e lidhin me Greqinë dhe kërkimet në ujërat mesdhetare, aleanca e SHBA-së me Turqinë është thelbësore në fushatën e administratës Trump për të shkatërruar milicinë shiite dhe përpjekjet e tjera të mbështetura nga Irani në Siri. Irani mbështet qeverinë e Presidentit Bashar al-Asad, ndërsa Turqia është kundër saj. Sipas "NYT", Shtetet e Bashkuara kanë gjithashtu një bazë ajrore masive në Incirlik, Turqi, ku ruajnë armët bërthamore taktike. Shtetet e Bashkuara nuk kanë kërkuar zyrtarisht të ndërmjetësojnë në mosmarrëveshjen midis Turqisë dhe Greqisë; kjo është trajtuar së fundmi nga Gjermania. Por në vërejtjet e tij publike të martën, Pompeo kërkoi me ngulm që dy vendet të kapërcenin ndasitë. "Ne mbështesim fuqimisht dialogun midis aleatëve të NATO-s, Greqisë dhe Turqisë, dhe i inkurajojmë ata të rifillojnë diskutimin e këtyre çështjeve sa më shpejt të jetë e mundur", tha Pompeo pas takimit me Mitsotakis. Ai përshkroi përparimin në përpjekjet e ndërmjetësimit nga NATO dhe tha se zhvillimet në detin e Mesdheut Lindor "duhet të nxisin bashkëpunimin dhe të sigurojnë një themel për sigurinë e qëndrueshme të energjisë dhe prosperitetin ekonomik të të gjithë rajonit".

### ERDOGAN

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ka thënë se Turqia nuk ka në plan të tërhiqet nga politikat e saj energjetike dhe se është e drejta e saj të kërkojë në ujërat ku ka dërguar anijet e saj, qoftë në Mesdheun Lindor, qoftë në Detin e Zi ku ka dërguar një anije të dytë për gaz dhe naftë. Mes mesazheve të tij, Erdogan ka paralajmëruar se Turqia e ka treguar përgjatë historisë se i mund kundërshtarët.



Sekretari Amerikan i Shtetit, Mike Pompeo dhe Kryeministri grek, Kyriakos Mitsotakis, duke vizituar bazën detare "Souda" në Kretë

### VIZITA E MËPARSHME NË QIPRO

Në fillim të këtij muaji, Pompeo vizitoi Qipron (që gjithashtu ka kundërshtuar veprimtaritë e Turqisë në ujërat e diskutueshme në Mesdheun Lindor) dhe deklaroi se Shtetet e Bashkuara janë thellësisht të shqetësuara për përdorimin e anijeve luftarake dhe avionëve luftarakë nga Turqia, në përpjekjet e saj për kërkimin e energjisë. Turqia pushtoi Qipron në 1974-ën dhe pretendoi Veriun e ishullit si territorin e saj, i cili nuk njihet askund tjetër në botë. Greqia dhe Turqia gati sa shkuan në luftë në 1996-ën për një ishull të pabanuar, një krizë e zbutur nga diplomacia amerikane.





**AKUZAT NGA ARMENIA PËR TURQINË**

Zyrtarët në Armeni pretendojnë se një nga avionët luftarakë armenë është rrëzuar nga një avion i Turqisë, në konfliktin e vendit me Azerbajxhanin për zonën e Nagorno-Karabakut. Ministria e Jashtme armene tha se piloti i SU-25 humbi jetën pasi u godit nga avioni F-16 turk në hapësirën ajrore armene. Sipas "BBC", Turqia, e cila me deklarata e ka mbështetur Azerbajxhanin në konflikt dhe ka akuzuar Armeninë se po cenon paqen rajonale, e ka mohuar akuzën. Të paktën 100 njerëz, përfshirë civilë, kanë vdekur në tri ditë luftime në rajonin e diskutueshëm malor. Nagorko-Karabak është zyrtarisht pjesë e Azerbajxhanit, por drejtohet nga armenët etnikë që nga viti 1994, me një marrëveshje të brishtë paqeje të negociuar nga Rusia. Konflikti më i ashpër mes dy palëve që atëherë ka ndodhur në vitin 2016, ku kanë humbur jetën 200 njerëz.

## Ish-Kryeministri Gruevski dënohet me një vit e gjysmë burg



Nikolla Gruevski

Ish-Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Nikolla Gruevski, është dënuar me një vit e gjysmë burg, ndërsa ish-ministri i Transportit, Mile Janakievski, me një vit burg me kusht. Ky i fundit do të evitojë burgun nëse në katër vitet e ardhshme nuk e përsërit veprën. Ata u shpallën fajtorë për veprën "Nxitje dhe organizim të protestave të dhunshme", para ambienteve të Komunës Qendër në verën e vitit 2013. Sipas prokurorisë, të pandehurit kishin organizuar turmën për të ndërhyrë në sallën e Këshillit Komunal me arsyetimin se janë kundër ndalimit të një kishe në Shkup. Këshilli Komunal drejtohet nga opozita, e cila kundërshtonte planet e qeverisë për ndryshimin e planit urbanistik. Rasti është zbuluar nga afera e përgjimeve që ishte publikuar nga viti 2013 deri në vitin 2014 nga lideri i atëhershëm i opozitës, Zoran Zaev, tashmë Kryeministër. Në një nga bisedat e publikuara është dëgjuar zëri i Gruevskit se si urdhëron Janakievskin të organizojë turmën për të "rrahur me shuplaka" disa nga drejtuesit e komunës, që të zmbrapsen nga vendimi. Gruevski është dënuar në mungesë meqë në nëntor të vitit 2018 është arratisur në Hungari për t'iu shmangur vuajtjes së një dënimi tjetër prej dy vitesh burg, për shpërdorim detyre.

Kryeministri: Shantazhi s'u ecën me mua, OK vetëm për fëmijët

# Rama: Qeveria s'ka punë me futbollin profesionist

*"Mesi-Ronaldo në gjyq për taksa, këtu lojtarët sikur janë pastrues"*

TIRANE

**Asnjë mirëkuptim nga qeveria për futbollin. Përkundrazi, me daljen e tij para mediave dje nga Kryeministria, kreu i qeverisë, Edi Rama, nuk dha asnjë sinjal lëshimi apo pranimi të propozimeve dhe kërkesave nga FSHF dhe Liga.**



Kryeministri Edi Rama dhe ministrat Ahmetaj e Denaj, dje gjatë konferencës

Madje, kreu i qeverisë shkoi deri në ekstrem, duke deklaruar se qeveria nuk ka punë me futbollin profesionist, por fokusin e ka te fëmijët. Në fjalën e tij, ai përmendi pagat e larta të futbollistëve që deklarohen si pastrues apo edhe pronarë që duan të bëjnë shkarkime te sporti, për detyrime që i kanë ndaj shtetit. Gjithashtu, atakoi edhe biznesmenët e pasur që kanë veshur fanellat e futbollit. Kreu i qeverisë e ka përsëritur që futbolli është i pavarur dhe gjuha e bojkotit dhe shantazhit nuk i shkon përballë tij... Ja deklarata e Kryeministrit Rama dje në Kryeministri:

**LIGJI I SPORTIT**

"Kemi bërë një ligj për sportin dhe kemi dhënë incentiva për futbollin që nuk i ka bërë askush më parë. Po që futbollistët të kërkojnë 10 vjet pa taksa, kjo nuk funksionon. Jemi dakord, për një periudhë starti pa taksa për të formalizuar pagat. E dimë shumë mirë që futbollistët s'paguhen me minimum jetik 230 mijë lekë si pastrueset. Ne po bëjmë minimumin 300 mijë lekë edhe për pastrueset, këta na deklarojnë nga 230 mijë lekë pagë, marrin shumë më tepër. Që të mos bëjmë spekulime, marrin mijëra euro e ne s'mund dot t'u themi s'keni taksë 10 vjet. Kjo nuk funksionon në një botë ku edhe Ronaldo e Mesi përfundojnë në Gjykatë e Prokurori për taksat. Ndërkohë që patjetër një ulje fillestare, patjetër një TVSH 6% për investimet në sport, që e kemi kaluar në parlament dhe është ligj. Patjetër që mund të shihet e s'ka problem, taksa e ndikimit në infrastrukturë për infrastrukturën sportive, pra, fusha, stadiume. Patjetër që jemi gati të bëjmë atë që duhet dhe për zinxhirin e fëmijëve".

**BASHKITË**

"Por historia e këtij futbolli me pronarë që duan të shkarkojnë nëpër klube paratë që i detyrohen shtetit si pronarë aktivitetesh të tjera, nuk kalon. As historia me biznesmenë të pasur që kanë veshur fanellën e futbollit dhe kujtojnë se mund të luajnë topash me qeverinë, nuk kalon. Ne jemi gati për të gjitha, por, ama, ka ardhur koha që edhe mbështetjet e bashkive, direkte, për klubet profesioniste të kalojnë në mbështetje për të tjerët, për sportin, dakord për fëmijët që luajnë futboll. Jemi okej (në rregull) për gjithçka që bëhet për fëmijët. Por te pjesa e profesionistëve, gjërat janë të ndara".

**LIGJET NË RAJON**

"Këto historitë me modele nga këtej e andej është mirë të mos na i tregojnë më se i tregojnë keq. I kemi parë modelet dhe e dimë shumë mirë se si janë zhvilluar vende të ndryshme. Në sa vjet ka shtet shqiptar, mblidhini të gjitha bashkë që për futbollin s'është bërë saç është bërë në këto vite. Ne do të vazhdojmë që të bëjmë për futbollin, por ama ka limit".

**BOJKOTI DHE SHANTAZHI**

"Habitem se si nuk e kanë mësuar akoma që gjuha e forcës, e bojkotit dhe shantazhit me mua nuk funksionon. Nuk e kuptoj dot arsyen pse këtyre u duhet bojkoti nëse nuk bëjnë një kalkulim që janë më rehat që janë më rehat me bojkot. Mund të jetë edhe kjo, unë s'e di. Nuk mund t'i akuzoj. Por mbase e kanë më rehat të bëjnë bojkot, u japin futbollistëve një minimum real mbase. Mbase jo, nuk e di. Nuk kanë taksirate apo shpenzime të tjera dhe bëjnë luftë me qeverinë. Kjo nuk funksionon. Nuk ka për të funksionuar kurrë. Duan të bojkotojnë, le të bojkotojnë, nuk ka problem. Është e drejta e tyre. Ata janë të pavarur nga qeveria. Komplet. Janë ent i pavarur nga qeveria. Ata me qeverinë thjesht e vetëm duhet të bashkëpunojnë, e çfarë të marrin është okej (në rregull)".

**QEVERIA DHE FUTBOLLI PROFESIONIST**

"Qeveria nuk ka detyrime ndaj futbollit profesionist. Qeveria ka detyrime ndaj sportit për të gjithë, fëmijëve, basketbollit, volejbollit. Të gjitha bashkë mund të ngrihen e të thonë po ne? Sepse faktikisht nuk janë pjesë as në Itali e jo më këtu, e një industrie fitimprurëse. Futbolli është industri".

**TAKSAT**

"Nëse këta mendojnë se mund ta mbajnë futbollin në epokën e feudalizmit me ngastra ku hidhet e pritet top e nga ana tjetër fshihen lekë këtë mund ta bëjnë, janë të pavarur. Por jo me ne. Çdo gjë që është e mundur, është e arsyeshme, e dobishme për vendin dhe futbollin, ne jemi gati. Por unë nuk shoh arsye pse të gjithë të tjerët, pse ju që jeni këtu (u drejtohet mediave të pranishme në konferencë), pse duhet që futbollistët të kenë 10 vjet pa taksa? Çfarë bëjnë ata, futbollistët, më shumë sesa ju? Ka shumë gjasa që disa nga ju (gazetarët) vrapojnë më shumë se ata (futbollistët). Edhe nga pikëpamja e vrapit. E keni parë ndonjëherë kur lozin. Me gjithë respektin për ta, por jo", deklaroi kryeministri Edi Rama, lidhur me kërkesat dhe çështjen e muajit të fundit ku futbolli është në bojkot total dhe proteston duke i kërkuar qeverisë ndryshimin e kuadrit ligjor për t'u rikthyer në shina formaliteti si edhe në rrugën e zhvillimit dhe mbijetesës ekonomike.

**Një muaj pa futboll, më 10 tetor në bulevardin kryesor**

## Bojkot edhe dy javë, Liga protestë te Kryeministria



Një muaj pa futboll, por në vend të tij bojkot dhe protestë. Klubet e Kategorisë Superiore kanë vendosur në mbledhjen e djeshme që bojkoti të vijojë dhe të pasohet me një protestë përpara kryeministrisë. Prej javësh, kërkesat dhe propozimet e klubeve po përballen me refuzim nga ana e qeverisë dhe kreut të saj, e ndërkohë edhe krerët e klubeve të Kategorisë Superiore janë të vendosura për të mos e vënë sferën e futbollit në mesfushë dhe të nisë normalisht aktiviteti për këtë sezon.

**Mbledhja -** Në orën 11:00, Liga Profesioniste e Futbollit, me praninë edhe të presidentit të FSHF-së, është mbledhur në ambientet e stadiumit "Air Albania" për të diskutuar mbi vijimësinë e bojkotit. Po, është e vërtetë që në rendin e ditës ka qenë diskutimi për bojkotin dhe mënyra si do të vijohet, duke parë dakordësinë e klubeve të Kategorisë Superiore për të mos zbritur në fushë për të nisur garën nëse nuk do të ketë një reagim pozitiv nga Kryeministri dhe qeveria mbi kërkesat për katër ligjet. Pas një mbledhjeje që ka zgjatur dy orë e 30 minuta, Liga doli me një qëndrim në faqen zyrtare në "Facebook".

**Liga -** "Deklaratë për shtyp, Tiranë 29.09.2020. Anëtarët e Ligës Profesioniste të Futbollit u mblodhën sot (dje) për të diskutuar në lidhje me çështjet organizative dhe me vijimin e bojkotit të kampionatit të Kategorisë Superiore. Gjatë diskutimeve, asambleja e Ligës u dakordësua për hapat e mëtejshëm në luftën për plotësimin e katër kërkesave të Ligës drejtuar qeverisë. LPF (Liga) do të intensifikojë kontaktet me negociatorin e qeverisë, z.Fidel Ylli, dhe për këtë ngarkohet kryetari i Ligës dhe sekretari i përgjithshëm për të ndjekur hap pas hapi ecurinë dhe reagimin e qeverisë pas dërgimit të relacionit shpjegues për kërkesat e Ligës. LPF (Liga) është e vendosur për vazhdimin e bojkotit dhe përshkallëzimin e protestave, duke projektuar protestën masive të futbollistëve më datë 10 tetor 2020. Për këtë do të ngrihet një grup pune për organizimin e saj dhe sensibilizimin e opinionit publik. Deri më tani nuk kemi asnjë reagim nga qeveria për kërkesat e Ligës. Anëtarët e Ligës Profesioniste të Futbollit mbeten shpresëplotë për një përgjigje sa më të shpejtë nga ana e qeverisë dhe për veprime konkrete në shqyrtimin dhe plotësimin e këtyre kërkesave që mund të sjellin zgjidhjen e ngërçit të krijuar", deklaroi Liga.

**Protesta -** Pas mbledhjes së djeshme, "Panorama Sport" ka mësuar se Liga ka vendosur për protestën masive që do të zhvillohet para kryeministrisë, më 10 tetor, në bulevardin qendror. Ideja e hedhur në mbledhje ka qenë që klubet e Superiores, bashkë edhe me skuadrat e moshave, të dalin në protestë për plotësimin e kërkesave.

**Trajneri i Tiranës**




## Egbo: Kemi 50% shanse, luajmë për historinë

*Emanuel Egbo beson te kualifikimi dhe histori. Tirana e tij udhëton drejt Zvicrës me idenë e qartë për të tentuar fazën e grupeve në Ligën e Europës dhe trajneri mendon se shanset janë 50 me 50. Gjatë konferencës së dhënë për mediat, ai thekson se gjen shpresë edhe tek ajo që bëri Skënderbeu në 2017-ës përballë tyre. "Do jetë ndeshje një ndeshje historike. Është e para herë që Tirana e gjen veten në "play off", ndaj duhet ta shijojmë atë në maksimumin. Të provojmë fatin tonë në fushë dhe të marrim atë që na takon. Pa ndeshje? Ka një plus dhe një minus, pasi për ne kampionati nuk ka filluar akoma. Jang Bojs kanë bërë 2 ndeshje në kampionat, pra, janë më në ritëm sesa ne. Kemi bërë vërtet vetëm miqësore, por edhe ato dy ndeshjet që kemi në Europë u kanë dhanë një impuls pozitiv lojtarëve. Kemi një lloj besimi, ndaj nuk do të hyjmë me të njëjtën frikë që kishim në ndeshjes së parë. Ekipi do të futet në lojë siç e filluam pjesën e dytë me Dinamon dhe si e luajtëm ndeshjen me Crvena Zvezdën. Presion? Jo, nuk kemi aspak. Nuk jemi në presion, janë ata që janë në presion. Luajmë në fushën e tyre dhe në letër janë ata më të mirë se ne. Do të shkojmë atje për të dhënë maksimumin nga vetja, ndaj shpresojmë që të na dalë. Shanset? Po, patjetër. Meqenëse është ndeshje teke, shanset janë 50% me 50% për t'u kualifikuar. Kush do të bëjë më pak gabime, do ta fitojë atë. Kalimi? Ne e kemi përgatitur ekipin dhe analizuar kundërshtarët, në ditën e ndeshjes do ta dimë si ta përballojmë. Duhet të shmangim ne gabimet dhe në të njëjtën kohë duhet të përfitojmë nga gabimet e atyre. Kështu mund ta fitojmë këtë duel. Jang Bojs? Për mua nuk kanë rëndësi emri. Rëndësi ka çfarë japin brenda fushës. Diferenca? Nuk ka shumë diferenca. Ekipi që do të bëjë më pak gabime brenda fushe do të kalojë. Është ekip që duhet vlerësohet maksimalisht. Ka lojtarë të gjatë dhe luajnë me topa të gjata. Ne jemi përgatitu që ta përballojmë në formën e duhur. Surprizë? Ne do të shkojmë në Zvicër dhe jo vetëm ne si ekip, por e gjitha Shqipëria. Tirana është i vetmi ekip që ka mbetur në Europë, ndaj duhet ta kemi besimin dhe të jemi pozitiv. Nëse shkojmë në këtë formë, atë që arriti Skënderbeu ndaj Jang Bojs, na jep besim se edhe ne mund t'ia dalim", ka deklaruar Egbo.*



DËSHIRONI TË KRYENI
TESTIMET PËR
COVID-19
?
LABORATOR I AKREDITUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË
PËRGJIGJE BRENDA 24 ORËVE
24
TESTIMI REAL TIME PCR (TAMPONI)
Vërtetoni me siguri të plotë nëse keni një infeksion aktiv me Coronavirus.
IgG
IgM
TESTIMI SEROLOGJIK PËR ANTITRUPAT
Përgjigje e saktë nëse keni krijuar përgjigje imunitare ndaj virusit.
PAKETAT E MONITORIMIT
• Gjak komplet + Sediment
• Proteina C reaktive (PCR)
• D-Dimer
• Fibronogjen
• Ferritina
• Elektrolitet
• Bilirubina Direkte
• Bilirubina Indirekte
• Bilirubina Totale
• ALT (SGPT)
• AST (SGOT)
• Kreatine Fosfokinaza (CPK)
• LDH
• Azotemi
• Kreatinemi
• Glicemi Esell
• Vitamina D (25-OH)
INTERMEDICA®
Life needs care
LABORATOR MJEKËSOR
INTERMEDICA QENDRORE
Rr. Panorama, pranë Hipotekës, Tiranë | Tel. 042200600 / Mob. 0686034558
www.intermedica.al | e-mail: info@intermedica.al




fab
Natyralisht
fab
ujë natyral oligomineral
natural oligomineral water
i mbushur në burimin
Kroi i Nënës Mbretëreshë
www.fab.al
HB
HYSENBELLIU
GROUP




Provo shijen e lehtë dhe freskuese 01
Premium
PRODUKT CILËSOR NGA BIRRA KORÇA
HB
01
Premium
PILSNER BEER
SHIJE E LEHTË DHE FRESKUESE
NATURAL
HB
HYSENBELLIU
GROUP